



RAPORT I MONITORIMIT TË KUVENDIT

SESIONI PRANVEROR 2016

PRISHTINË, SHTATOR 2016





RAPORT I MËMONITORIMIT TË KUVENDIT

SESIONI PRANVEROR 2016

PRISHTINË, SHTATOR 2016



COPYRIGHT © 2016. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.n.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA

“Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së.

PËRMB

1. HYRJE.....	9
2. ANALIZA E PUNËS SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE	10
2.1 KOMISIONI PËR BUXHET DHE FINANCA.....	12
2.2 KOMISIONI PËR TË DREJTAT, INTERESAT E KOMUNITETEVE DHE PËR KTHIM	12
2.3 KOMISIONI PËR LEGJISLACION, MANDATE, IMUNITETE, RREGULLOREN E KUVENDIT DHE MBIKËQYRJEN E AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT	13
2.4 KOMISIONI PËR INTEGRIME EVROPIANE	13
2.5 KOMISIONI PËR PUNË TË JASHTME	14
2.6 KOMISIONI PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI, KULTURË, RINI DHE SPORT	14
2.7 KOMISIONI PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI	15
2.8 KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI, MJEDIS E PLANIFIKIM HAPËSINOR	15
2.9 KOMISIONI PËR SHËNDETËSI, PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE.....	16
2.10 KOMISIONI PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE MBIKËQYRJEN E FSK-SË.....	16
2.11 KOMISIONI PËR ADMINISTRATË PUBLIKE, QEVERISJE LOKALE DHE MEDIA	17
2.12 KOMISIONI PËR MBIKËQYRJE TË FINANCAVE PUBLIKE	17
2.13 KOMISIONI PËR MBIKËQYRJEN E AGJENSIONIT KOSOVAR PËR INTELIGJENCË	18
2.14 KOMISIONI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, BARAZI GJINORE, PËR PERSONA TË PAGJETUR DHE PETICIONE	18
2.15 KOMISIONI PARLAMENTAR PËR STABILIZIM ASOCIIM.....	18
2.16 NËN-KOMISIONI PËR MANDATE, IMUNITETE DHE RREGULLOREN E KUVENDIT	19

BAJTJA

3. MBARËVAJTJA E SEANCAVE PARLAMENTARE	20
4. PËRMBUSHJA E AGJENDËS LEGJISLATIVE.....	23
5. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE.....	25
5.1 PYETJET PARLAMENTARE	25
5.2 INTERPELANCAT	28
5.3 MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË LIGJEVE	28
5.4 MBIKËQYRJA E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA	29
6. LOJALITETI I DEPUTETËVE NDAJ GRUPEVE PARLAMENTARE	30
7. UDHËTIMET E DEPUTETËVE JASHTË VENDIT	32
8. SHPENZIMET E KUVENDIT.....	33
9. REKOMANDIMET	34
ANEKS 1. PJESËMARRJA E DEPUTETËVE NË TAKIMET E KOMISIONEVE PARLAMENTARE	36
ANEKS 2. PJESËMARRJA E DEPUTETËVE NË SEANCA	42
ANEKS 3. PYETJET PARLAMENTARE SIPAS SEKTORËVE	46

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Puna e komisioneve parlamentare gjatë sesionit pranveror të këtij nuk ka qenë shumë produktive. Bojkotimi i mbledhjeve të komisioneve nga partitë opozitare ka ulur dukshëm konstruktivitetin e debatit dhe ka ndikuar në mbarëvajtjen e mbledhjeve, pasi që në mungesë kuorumi 19 mbledhje kanë dështuar të mbahen. Komisionet parlamentare kanë mbajtur gjithsej 223 mbledhje të rregullta dhe 13 dëgjime publike. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2015, ku janë mbajtur 286 mbledhje të rregullta dhe 32 dëgjime publike, shohim se në 2016 janë mbajtur më pak 63 mbledhje të rregullta dhe 19 dëgjime publike.

Kuvendi ka shënuar rënie sa i përket mbajtjes së seancave krahasuar me periudhat e më hershme. Janë mbajtur 14 seanca plenare, ndërsa nëntë herë seancat kanë vazhduar për një ditë tjetër. Në vitin 2015, në sesionin pranveror, Kuvendi kishte mbajtur 23 seanca plenare apo nëntë më shumë. Numri i vogël i seancave ka dobësuar produktivitetin e punës së Kuvendit. Kuvendi i ka zhvilluar punimet pa miratuar një plan të punës, siç parashihet me Rregulloren. Në anën tjetër Qeveria në programin e vet legjislativ ka planifikuar të dorëzoi në Kuvend 87 projektligje, prej të cilave deri në fund të sesionit pranveror i dorëzoi 23. Gjithsej programi legjislativ i Kuvendit ka përmbytur 135 projektligje, duke u bazuar në planet e punës të miratuar nga komisionet. Nga këto projektligje, në sesion pranveror janë miratuar 35 ligje (25.9%), në procedurë të komisioneve parlamentare kanë mbetur 20 projektligje (14.8%) përderisa 80 (59%) të tjera nuk janë dorëzuar ende në Kuvend nga Qeveria. Sfiduese për Kuvendin vazhdon të mbetet iniciimi i legjislationit. Kuvendi ka ndërmarrë vetëm një nismë ligjore. Duhet theksuar se një projektligj tjetër që është bartur nga viti i kaluar ka qenë iniciativë qytetare. Të gjitha projektligjet tjera të shqyrtuara janë të sponsorizuara nga Qeveria.

Gjatë periudhës raportuese Kuvendi ka shfrytëzuar shumë pak mekanizmat e mbikëqyrjes së ekzekutivit, duke shënuar dobësim të rolit të vet mbikëqyrës. Prej 120 deputetëve vetëm 24 kanë parashtruar pyetje parlamentare, përderisa 96 deputetë të tjerë nuk kanë parashtruar asnjë pyetje parlamentare. Gjithsej janë parashtruar 83 pyetje parlamentare, prej të cilave 45 (54%) kanë marrë përgjigje kurse 38 (46%) janë refuzuar nga anëtarët e kabinetit qeveritar. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur janë parashtruar 201 pyetje parlamentare, këtë vit janë

118 më pak. Është paraparë mbikëqyrja e zbatimit të 23 ligjeve. Nga numri i përgjithshëm i ligjeve të planifikuara për t'u mbikëqyrur, vetëm për 5 prej tyre është arritur të dorëzohen raportet në Kuvend, kurse 18 të tjera kanë mbetur të pa mbikëqyrura. Në procedurë të mbikëqyrjes kanë mbetur edhe shtatë ligje të tjera.

Nga krahasimi i lojalitetit të deputetëve ndaj qëndrimeve të grupeve të tyre parlamentare, shohim se grupi parlamentar që ka pësuar më së shumti rritje të lojalitetit për 2% është Lista Serbe, kurse grupi parlamentar i PDK-së dhe LDK-së kanë shënuar ulje të nivelit të lojalitetit për 2%. Ndërsa grupet e tjera parlamentare nuk kanë pësuar ndryshime. Nga matja e lojalitetit në bazë të gjinisë del që burrat dhe gratë deputete në Kuvendin e Kosovës kanë të njëjtin nivel të lojalitetit me 93%. Përkundër përqindjes së lartë të lojalitetit të të dy gjinive, niveli i barabartë i lojalitetit është një tregues që thyen paragjykimet për një lojalitet më të madh të grave sesa të burrave.

Në anën tjetër deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë qenë mjaft aktiv sa i përket udhëtimeve jashtë vendit, duke realizuar 128 udhëtime. Këto udhëtime i kanë kushtuar buxhetit të Kuvendit rreth 110 mijë euro. Kuvendi ka shënuar progres sa i përket transparencës financiare. Shpenzimet e Kuvendit, ndonëse me vonesë, janë publikuar në mënyrë më të detajuar. Qasja në dokumente publike është mjaftë e kënaqshme. Hapa pozitiv janë bërë edhe në drejtim të zbatimit të planit të veprimit për transparencë parlamentare. Mbledhjet e Kryesisë dhe të trupave të tjerë të Kuvendit janë të hapura.

1. HYRJJE

Ky raport paraqet vlerësimin e punës së Kuvendit për periudhën janar – shtator 2016, përkatësisht të sesionit pranveror. Gjatë periudhës raportuese, KDI ka përcjellë në mënyrë aktive mbarëvajtjen e punimeve të Kuvendit dhe përputhshmërinë me Rregulloren e Punës. Raporti përmban të dhëna të shumta statistikore që janë mbledhur nga monitoruesit tanë, të cilët kanë përcjellë të gjitha mbledhjet e komisioneve parlamentare, Kryesisë së Kuvendit si dhe seancat parlamentare. Këto të dhëna janë analizuar dhe krahasuar më ato të vitit paraprak, për të sjellë një pasqyrë më të qartë të punës së Kuvendit.

Pjesa e parë e raportit analizon punën e komisioneve parlamentare, më saktësisht vlerësimin e përmbushjes së planeve të tyre të punës. Pjesa e dytë e raportit trajton mbarëvajtjen e seancave, përmbushjen e agjendës legjislativë si dhe dinamikën e miratimit të ligjeve. Hapësirë më e madhe i është dhënë mbikëqyrjes parlamentare. Në raport është përfshirë edhe matja e lojalitetit të deputetëve në relacion me grupin parlamentar, udhëtimet jashtë vendit si dhe shpenzimet e Kuvendit.

Përmbushja e agjendës legjislativë vazhdon të mbetet e ulët në raport me planifikimet, kjo edhe për shkak të ngecjes së Qeverisë për të dorëzuar në Kuvend projektligjet e parapara për miratim. Mungesa e bashkëpunimit të ndërsjellë Kuvend-Qeveri gjatë planifikimeve të legjislacionit, dhe mungesa e iniciativave ligjore nga ana e vet Kuvendit, kanë ndikuar në efikasitetin e ulët në procesin ligjvënës. Kompetencat mbikëqyrëse pothuajse nuk janë ushtruar fare përgjatë këtij sesioni. Mungesa e opozitës dukshëm ka zbehur këtë rol. Shumica e deputetëve të partive në pushtet nuk e kanë ushtruar mandatin e tyre për të mbikëqyrur ekzekutivin. Pyetjet parlamentare kanë qenë të pakta dhe më shumë me karakter promovues për ministrat. Shumë nga to kanë mbetur edhe pa përgjigje. Asnjë interpelancë parlamentare nuk është mbajtur përdërisa ministrat kanë vazhduar t'iu shmangen raportimeve në komisionet parlamentare.

Vështirësitë me të cilat është ballafaquar Legjislatura e V-të e Kuvendit kanë qenë të shumta, ndonëse më shumë të natyrës politike. Inatet e akumuluarat të subjekteve politike gjatë konstituimit të Kuvendit dhe krizës politike të atëhershme, kanë reflektuar edhe në këtë sesion. Kundërshtimi i Marrëveshjes për asociacionin e komunave me

shumicë serbe dhe Marrëveshjes së shënimit të vijës kufitare me Malin e Zi, kanë mbizotëruar në diskutimet e deputetëve, edhe pse asnjëra prej këtyre dy marrëveshjeve nuk ka qenë zyrtarisht për shqyrtim në seanca plenare. Zgjedhja e Presidentit, si rrallë në ndonjë vend, është shoqëruar me hedhje të gazit lotsjellës në seancë duke u pasuar me arrestimet e deputetëve të subjekteve opozitare. Punimet e Kuvendit në pjesën më të madhe të sesionit janë bojkotuar nga opozita, gjë që ka shkaktuar dështimin e disa seancave dhe mbledhjeve të komisioneve për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm. Mbledhjet e komisioneve parlamentare ku kryetarët kanë qenë nga opozita, gjatë periudhës së bojkotit janë udhëhequr nga zëvendëskryetarët.

2. ANALIZA E PUNËS SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

Puna e komisioneve parlamentare gjatë sesionit pranveror të këtij viti nuk ka qenë shumë produktive. Bojkotimi i mbledhjeve të komisioneve nga partitë opozitare, i filluar në shtatorin e vitit të kaluar ka vazhduar deri në muajin qershor kur janë kthyer në Kuvend deputetët e LVV-së, përderisa deputetët e AAK-së dhe Nismës kanë munguar deri në fund të sesionit. Mungesa e opozitës në punimet e komisioneve e ka ulur dukshëm konstruktivitetin e debatit dhe ka ndikuar në mbarëvajtjen e mbledhjeve, pasi që në mungesë kuorumi 19 mbledhje kanë dështuar të mbahen. Një element tjetër që është vërejtur gjatë monitorimit të punës së komisioneve parlamentare ka qenë pasiviteti i deputetëve nga grupi parlamentar Lista Serbe, të cilët nuk kanë shprehur interesim për t’u përfshirë në diskutimet e komisioneve.


Komisionet parlamentare kanë mbajtur gjithsej 223 mbledhje të rregullta dhe 13 dëgjime publike. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2015, ku janë mbajtur 286 mbledhje të rregullta dhe 32 dëgjime publike, shohim se në 2016 janë mbajtur më pak 63 mbledhje të rregullta dhe 19 dëgjime publike.

Dëgjimet publike janë një prej formave me anë të cilave komisionet u japin hapësirë grupeve të interesit që të përfshihen në diskutime, qoftë për shqyrtim të projektligjeve apo për çështje të tjera që janë në interes të publikut. Nga 13 dëgjimeve publike të mbajtura këtë sesion, në nëntë prej tyre tema e diskutimit ka qenë shqyrtimi i projektligjeve të caktuara ndërsa në katër prej tyre është diskutuar për monitorim të zbatimit të ligjeve.

Përgjatë këtij sesioni ka pasur disbalancë të performancës së punës ndërmjet komisioneve. Përderisa Rregullorja e Kuvendit obligon komisionet të takohen të paktën dy herë në muaj, kësaj dispozite i janë përmbajtur vetëm tetë nga 15 komisionet e Kuvendit, ndërsa shtatë të tjera nuk e kanë përmbushur këtë kërkesë minimale. Ky disbalancë vërehet më së miri kur krahasohet Komisioni për Punë të Jashtme që nuk ka mbajtur asnjë mbledhje për gati tre muaj radhazi, me Komisionin për Arsimit që ka mbajtur deri në pesë mbledhje brenda një muaji.

Përveç numrit të takimeve të komisioneve, monitorimi jonë ka përfshirë edhe kohëzgjatjen e takimeve. Të gjitha komisionet kanë punuar gjithsej 220 orë e 54 minuta. Kom-

► FIGURA 1. Krahasimi i takimeve të komisioneve parlamentare të sesionit pranveror 2015 me 2016



► **TABELA 1. MBLEDHJET E KOMISIONEVE PARLAMENTARE, DËGJIMET PUBLIKE DHE ORËT E PUNËS**

Emërtimi i komisionit	Mbledhje të mbajtura	Dëgjime Publike	Orët e punës	Mungesat e deputetëve	Vonesat e deputetëve
Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport	24	4	28.16	92	21
Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit	25	1	25.59	104	15
Buxhet dhe Financa	22	0	22.24	74	12
Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri	25	3	18.28	92	21
Të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim	21	0	17.29	98	15
Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor	17	0	16.03	42	7
Mbikëqyrja e Financave Publike	11	1	13.15	40	7
Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje e Forcës së Sigurisë së Kosovës	9	2	13.08	17	9
Të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	10	1	13.05	31	11
Integritet Evropian	14	0	11.31	64	8
Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	14	1	11.24	54	7
Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media	10	0	9.29	34	7
Stabilizim Asociim	5	0	8.43	10	/
Punë të Jashtme	9	0	7.50	27	3
Mbikëqyrja e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë	7	0	/	34	/
Nën-Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit	2	0	1.45	/	/

sioni me më së shumti orë pune ka qenë Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport me 28 orë e 16 minuta, i pasuar nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit me 23 orë e 59 minuta dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa me 22 orë e 24 minuta. Ndërsa më së paku orë pune gjatë këtij sesioni janë Nën – Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit me 1 orë e 45 minuta, i pasuar nga Komisioni për Punë të Jashtme me 7 orë e 50 minuta dhe Komisioni për Stabilizim Asociim me 8 orë 43 minuta. Në matjen e kohëzgjatjes së takimeve të komisioneve, nuk përfshihet Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë¹.

¹ Takimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë mbahen me dyer të mbyllura prandaj nuk ka qenë e mundur matja e kohëzgjatjes së takimeve të këtij komisioni. Mbyllja e takimeve përcaktohet me Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, neni 36, pika 5.

Në këtë sesion numri i përgjithshëm i projektligjeve të shqyrtuara ka qenë i vogël në krahasim me numrin e atyre që ishin paraparë për shqyrtim në plan të punës të secilit komision. Ndër arsytet pse komisionet nuk kanë përm-bushur planet për shqyrtim të projektligjeve ka qenë mos procedimi i tyre në Kuvend nga ana e Qeverisë, si sponsoruesi kryesor i agjendës legjislative.

Hartimi i ligjeve nga ana e Kuvendit është një prej roleve kryesore të këtij institucioni, mirëpo iniciativa të tilla kanë munguar këtë sesion. Vetëm një nismë ligjore është ndërmarrë nga Kuvendi, perkatësisht nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Kjo nismë kishte për qëllim plotësim-ndryshimin e Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.



Dobësi e punës së komisioneve parlamentare këtë sesion ka qenë edhe mbikëqyrja parlamentare, respektivisht mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve. Vetëm pesë komisione kanë arritur të përfundojnë procesin e monitorimit të zbatimit të nga një ligji që bie në fushë-veprimtarinë e tyre, që nënkupton që janë monitoruar vetëm pesë ligje nga gjithsej 18 sa ishin paraparë të monitorohen.

2.1 KOMISIONI PËR BUXHET DHE FINANCA

Komisioni për Buxhet dhe Financa (KBF) ka mbajtur 22 mbledhje të rregullta dhe asnjë dëgjim publik. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, këtë vit janë mbajtur tri mbledhje më pak. Mungesa e kuorumit e ka përcjellë KBF-në ashtu si shumë komisione të tjera, ku tri mbledhje të planifikuara kanë dështuar të mbahen.

Në Planin e Punës për vitin 2016 për sesionin pranveror, ky komision ka paraparë shqyrtimin e 11 projektligjeve. Gjithsej janë shqyrtuar 12 projektligje, prej të cilave vetëm katër kanë qenë të parapara për këtë sesion, ndërsa pa u shqyrtuar kanë mbetur shtatë projektligje të cilat kanë qenë të planifikuara të shqyrtohen në sesionin pranveror. Në cilësinë e komisionit të përhershëm janë shqyrtuar 25 projektligje, të cilat janë dërguara nga komisionet tjera për të vlerësuar implikimet financiare.

Katër projektligje janë shqyrtuar me procedura të përsheptuara, të cilat kanë qenë si në vijim: Projektligji për Prokurimin Publik, Projektligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit dhe Projektligji për plotësim ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e Kosovës 2016, si dhe Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal.

Për prezantim të projektligjeve është ftuar dy herë Ministri i Financave Abdullah Hoti, përderisa kanë munguar aktivitetet mbikëqyrëse ndaj ekzekutivit. Në planin e punës ka qenë e paraparë mbikëqyrja e zbatimit të dy ligjeve të cilat nuk janë realizuar. Ligjet e parapara për mbikëqyrje kanë qenë: Ligji për Akcizën në Produktet e Duhanit (për të cilin kanë filluar aktivitetet), si dhe Ligjit për Partneritetin Publiko-Privat.

Gjatë kësaj kohe janë shqyrtuar edhe raportet vjetor financiare për vitin 2015-të të 21 institucioneve dhe agjencioneve të pavarura. Disa prej këtyre raporteve janë shqyrtuar me kujdes, përderisa një pjesë tjetër janë votuar pa shqyrtim paraprak. Kjo ka ndodhur për shkak se brenda

një mbledhjeje janë paraparë të shqyrtohen deri në pesë raporte, dhe kjo ka bërë që mbledhjet të zgjasin shumë dhe deputetët kanë humbur interesimin. Si rrjedhojë e kësaj, vetëm raportet e renditura më lartë në rendin e ditës kanë pasur vëmendjen e plotë të deputetëve.

Ndër pikat e dobëta të KBF - së ka qenë shqyrtimi i Projektligjit për plotësim/ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, i cili është bërë në mbledhje me dyer të mbyllura. Tradicionalisht, anëtarët e këtij komisioni janë më të privilegjuar kur të hartohet buxheti, ngase si pasojë e mungesë së debatit për buxhetin, këta anëtar arrijnë që në buxhet të shtyjnë përpara projekte të cilat favorizojnë më shumë regjionet prej ku e kanë bazën e tyre elektorale, që konvertohet në më shumë vota në zgjedhjet e ardhshme në dëm të kandidatëve tjerë. Pastaj, gjuhë joparlamentare e përdorur nga kryetari i komisionit Naser Osmani, i cili në një rast ka ofenduar deputeten Shqipe Pantina. Po ashtu, në temat e trajtuara nuk ka pasur asnjë rast konkret kur është diskutuar për çështjet në interes të komuniteteve apo të grave. Vonesat në fillimin e mbledhjeve kanë qenë të zakonshme, pasi që anëtarët nuk i janë përmbajtur orarit të caktuar.

2.2 KOMISIONI PËR TË DREJTAT, INTERESAT E KOMUNITETEVE DHE PËR KTHIM

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim ka mbajtur 21 mbledhje të rregullta dhe asnjë dëgjim publik. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, këtë vit numri i mbledhjeve është më i madh për tri mbledhje. Në cilësinë e komisionit të përhershëm ka shqyrtuar 30 projektligje, të cilat janë dërguar nga komisionet tjera për t'u shqyrtuar në aspektin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Në planin e punës komisioni nuk ka paraparë të shqyrtojë ndonjë projektligj si komision raportues.

Është planifikuar të mbikëqyrjet zbatimi i tri ligjeve, përfshirë Ligjin për Shërbyesit Civil që është bartur nga viti i kaluar dhe në të cilin është vazhduar të punohet edhe në vitin 2016. Pa u mbikëqyrë ka mbetur Ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Gjashtë ministra të linjës janë planifikuar të thirren për raportim me qëllim që komisioni të informohet për çështje që janë në kompetencë të tij, mirëpo asnjë nga ta nuk është ftuar gjatë këtij sesioni.

Meqenëse çështjet që ndërlidhen me komunitetet bien në fushë-veprimtarinë e këtij komisioni, kjo temë ka mbi-



zotëruar agjendën e komisionit. Ndërsa çështjet që janë në interes të grave nuk janë ngritur asnjëherë për diskutim.

Përveç shqyrtimit të projektligjeve në cilësinë e komisionit të përhershëm, ky komision nuk ka kryer detyrat tjera mbikëqyrëse ndaj ekzekutivit. Shumë nga projektligjet që kanë qenë në shqyrtim në këtë komision kanë kaluar pa diskutim.

2.3 KOMISIONI PËR LEGJISLACION, MANDATE, IMUNITETE, RREGULLOREN E KUVENDIT DHE MBIKËQYRJEN E AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit ka realizuar 26 takime. Prej tyre 25 mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publik. Krahasuar me sesionin pranveror të vitit të kaluar ku janë mbajtur 33 mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publik, këtë vit dinamika e punës ka qenë më e ulët. Ndryshe nga komisionet tjera ku kanë dështuar mbledhjet për shkak të mos plotësimit të kuorumit që ka ardhur si pasojë e bojkotimit të Kuvendit nga opozita, Komisionit për Legjislacion nuk i ka dështuar asnjë takim për këtë arsye. Si komision i përhershëm ka shqyrtuar katër projektligje, mirëpo ka bërë shqyrtimin edhe të 28 raporteve me amendamente të projektligjeve të ndryshme nga komisionet funksionale.

Nuk është ngritur ndonjë çështje në interes të grave. Sa i përket ngritjes së çështjeve në interes të komuniteteve, është diskutuar projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Ky projektligj ka të bëjë edhe me komunitetet, por që rrjedh nga marrëveshjet e Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për kthimin e li-brave kadastral.

Plani i Punës nuk është përmbushur plotësisht siç ka qenë i paraparë për këtë periudhë. Nga 10 projektligje të planifikuar për t'u shqyrtuar, janë shqyrtuar vetëm katër. Sa i përket dëgjimeve publike në Plan të Punës janë planifikuar pesë, ndërsa është mbajtur vetëm një. Komisioni ka planifikuar monitorimin e dy ligjeve: Ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë dhe Ligjin për provi-

min e jurisprudencës, mirëpo përveç caktimit të grupeve punuese, procedurat e monitorimit nuk kanë filluar gjatë periudhës raportuese.

Komisioni në planin e punës ka të planifikuar shqyrtimin e raporteve vjetore për agjencitë e pavarura, mirëpo nuk e ka caktuar sa agjenci apo cilat raporte do të shqyrtohen. Gjithsej janë shqyrtuar tri raporte vjetore të punës, të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas dhe Institutit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni ka bërë mbikëqyrjen buxhetore të institucioneve që bien në fushëveprim të komisionit dhe në muajin qershor ka nxjerrë rekomandime që janë diskutuar në mbledhje.

Edhe pse ka pasur mungesa nga anëtarët e komisionit, gjatë kohës sa kanë qenë prezent shumica prej tyre kanë qenë mjaft aktiv nëpër diskutime dhe i janë përkushtuar shqyrtimit të projektligjeve, duke dhënë sugjerime apo duke komentuar nenet e caktuara.

Një nga pikat e dobëta të punës së komisionit gjatë sesionit pranveror konsiderohet të jetë mos raportimi i ministrave në këtë komision. Asnjë ministër nuk është ftuar për raportim edhe pse është komision i përhershëm. Duke marrë parasysh që opozita nuk ka marrë pjesë në asnjë nga mbledhjet deri në qershor, atmosfera në komision ka qenë gjithmonë e relaksuar dhe nuk ka pasur asnjëherë përplasje apo diskutime mes anëtarëve.

2.4 KOMISIONI PËR INTEGRIME EVROPIANE

Komisioni për Integritim Evropian ka mbajtur gjithsej 14 mbledhje të rregullta dhe asnjë dëgjim publik. Në krahasim me sesionin pranveror të vitit 2015 ku janë mbajtur 25 mbledhje dhe dy dëgjime publike, numri i takimeve për këtë sesion është më i vogël për 11 mbledhje. Ky komision është një prej komisioneve që ka pasur më së shumti mbledhje të dështuara për shkak të mungesës së kuorumit. Përveç numrit të vogël të mbledhjeve, ky komision është shoqëruar edhe me mungesa të shumta të deputetëve por edhe me zëvendësime të anëtarëve.

Në cilësinë e komisionit të përhershëm janë shqyrtuar 29 projektligje nga aspekti i vlerësimit të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, projektligje të cilat janë shqyrtuar paraprakisht nga komisionet funksionale. Ndërsa sa i përket shqyrtimit të projektligjeve që bien në fushëveprimin e këtij komisioni, ky i fundit nuk ka paraparë asnjë në planin e punës.



Në Planin e Punës është paraparë të mbikëqyret zbatimi i dy ligje prej të cilave është përfunduar vetëm njëri, ai për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Vepër Penale. Në rolin e mbikëqyrjes, komisioni kishte planifikuar që për këtë sesion të ftojë në raportim nëntë ministra. Ndonëse janë ftuar vetëm tre prej tyre, megjithatë në këtë aspekt qëndron më mirë sesa komisionet tjera. Ministrat që kanë raportuar janë: Ministri i Tregtisë dhe Industrisë Hykmete Bajrami, Ministri i Integritetit Evropian Bekim Çollaku dhe tashmë ish-ministri i Drejtësisë Hajredin Kuçi.

Nga të gjitha takimet e mbajtur, vetëm një herë janë ngritur çështje që kanë të bëjnë me interesat e grave më konkretisht për mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Po ashtu, tri herë janë ngritur çështje që kanë të bëjnë me komunitetet, më saktësisht për komunitetin rom nga deputeti Kujtim Paqaku.

2.5 KOMISIONI PËR PUNË TË JASHTME

Komisioni për Punë të Jashtme (KPJ) ka realizuar nëntë takime ndërsa nuk ka mbajtur asnjë dëgjim publik. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, numri i mbledhjeve për këtë sesion është dukshëm më i vogël për gjashtë mbledhje më pak.

Plani i Punës së KPJ është shumë i mangët nga aspekti ligjvënës, pasi që për të gjithë vitin është paraparë të shqyrtohet vetëm një projektligj, ai për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës. Ky projektligj është shqyrtuar në komision por që ende nuk i është proceduar seancës plenare për miratim. Përveç këtij projektligji, janë shqyrtuar edhe tri projektligje të tjera për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, prej të cilave edhe “Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi”, i cili është shoqëruar me shumë polemika dhe debate të ashpra mes partive në pushtet dhe atyre në opozitë. Madje, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht, ku ishte paraparë shqyrtimi i projektligjit në fjalë, pas diskutimeve të ashpra u hodh gaz lotsjellës. Përkundër situatës kaotike të shkaktuar nga hedhja e gazit lotsjellës, ky projektligj është miratuar nga komisioni.

Në Plan të Punës është paraparë edhe raportimin i dy ministrave, atij për Punë të Jashtme dhe Integritetit Evropian, mirëpo asnjëri prej këtyre takimeve nuk është mbajtur. Diskutimet mes anëtarëve të komisionit nuk kanë qenë produktive pasi që rrallë herë janë diskutuar detajisht pikat e rendit të ditës, vetëm kanë miratuar çfarëdo që ka qenë në agjendë. Mbledhjet kanë zgjatur shumë shkurt, pa diskutime përmbajtësore.

2.6 KOMISIONI PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI, KULTURË, RINI DHE SPORT

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport ka mbajtur gjithsej 28 takime, prej tyre 24 mbledhje dhe katër dëgjime publike. Nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2015, numri i takimeve të mbajtura është më i madh këtë sesion ndërsa sa i përket dëgjimeve publike, numri i tyre për këtë sesion është dukshëm më i vogël, me shtatë dëgjime më pak. Përkundër kësaj, ky komision prinë për numrin më të madh të takimeve të mbajtura nga të gjitha komisionet tjera.

Në Planin e Punës janë paraparë që të shqyrtohen në parim katër projektligje, prej të cilave vetëm një është shqyrtuar. Ndërsa në shqyrtim të dytë janë paraparë të jenë pesë projektligje prej të cilave janë shqyrtuar katër, mirëpo vetëm një është proceduar në seancë plenare për lexim të dytë. Tre nga këto projektligje janë bartur nga viti 2015.. Po ashtu është shqyrtuar edhe një projektligj për ratifikim të një marrëveshje ndërkombëtare, përkatësisht Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë dhe MASHT-it për Programin “Fullbright” për Shkëmbim Akademik. Sa i përket shqyrtimit të raporteve të organeve të pavarura, komisioni nuk ka shqyrtuar asnjë raport edhe pse në Planin e Punës për vitin 2016 në sesionin pranveror janë paraparë të shqyrtohen dy të tilla. E njëjta situatë është edhe me shqyrtimin e raporteve financiare të ministrave të linjës, ku janë paraparë të shqyrtohen katër raporte mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Në raportim janë ftuar ministrat nga ministritë e linjës, një herë ka qenë i ftuar Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami i cili i është përgjigjur pozitivisht ftesës dhe dy herë është ftuar Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Shala që po ashtu i është përgjigjur pozitivisht ftesës.

Çështjet në interes të komuniteteve dhe çështjet e grave nuk kanë qenë në fokus të diskutimeve të këtij komisioni. Deputetja Mufera Sinik ka qenë e vetmja që në katër raste në mënyrë të tërthortë ka ngritur çështje në interes të komuniteteve, kryesisht për komunitetin turk.

Përkundër numrit të madhe të mbledhjeve të mbajtura në raport me komisionet e tjera, këtij komisioni i ka munguar produktiviteti në punë. Mos përkushtimi i duhur gjatë shqyrtimit të projektligjeve ka prodhuar defekte të shumta. Projektligji për Kinematografinë, një projektligj mjaft i rëndësishëm tanimë është tërhequr nga vetë Ministri Ku-



itim Shala, pasi që ka marrë kritika të shumta lidhur më përmbajtjen e tij. Gjatë shqyrtimit të dytë në seancë për shkak të mospajtimeve të deputetëve rreth amendamenteve, ministri kishte propozuar që ky projektligj të kthehej sërish në grup punues. Edhe pas shumë diskutimeve me grupet e interesit dhe shqyrtimit nga ana e komisionit nuk ishte arritur të gjendet zgjidhje për mospajtimet për amendamentet përkatëse. Ajo që është vërejtur në takimet e këtij komisioni është mos dhënia e hapësirë së mjaftueshme grupeve të interesit që të përfshihen në shqyrtimin e projektligjeve.

2.7 KOMISIONI PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka mbajtur 25 mbledhje të rregullta dhe tri dëgjime publike. Pothuajse numër të njëjtë të takimeve kishte realizuar edhe në sesionin pranveror të vitit të kaluar, apo gjithsej 26 mbledhje të komisionit dhe tri dëgjime publike. Në mungesë të kuoromit, tri mbledhje të komisionit kanë dështuar të mbahen, ndërsa për shkak të vonesave të anëtarëve të komisionit mbledhjet kryesisht kanë filluar me vonesë.

Në Planin e Punës për sesionin pranveror është paraparë shqyrtimi i 16 projektligjeve. Nga këto 16 projektligje janë shqyrtuar 10. Projektligji që u konsiderua si më i rëndësishëm, i paraparë për shqyrtim në sesionin pranveror ishte Projektligji për Trepçën, mirëpo gjatë këtij sesioni Qeveria nuk e ka sjellë atë në Kuvend edhe përkundër insistimit të komisionit. Dy projektligje, ai për Patentëshofer dhe për Rregullat e Komunikacionit Rrugor, pas shqyrtimit të dytë në seancë i janë kthyer komisionit për shqyrtim të tretë, kjo pasi që komisioni nuk kishte pranuar të gjitha amendamentet e komisioneve të përhershme. Të dy projektligjet në lexim të tretë kanë marrë miratimin përfundimtar nga Kuvendi. Projektligji për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës i shqyrtuar nga ky komision ka qenë një prej projektligjeve që ka zgjuar më së shumti debat në Kuvend, andaj edhe nuk është miratuar gjatë shqyrtimit të dytë. Mospajtimet mes partnerëve të koalicionit qeverisës kanë bërë që çështja e këtij projektligji të mbetet e pezulluar për një afat të pacaktuar. Ishte planifikuar mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Miniera dhe Minerale por formimi i grupit punues për ishte bërë me vonesë prej katër muajve dhe ky proces nuk është realizuar.

Pesë raporte vjetore të agjencive të pavarura janë shqyrtuar. Asnjë ministër nuk është ftuar për raportim, si dhe

nuk është shtruar ndonjë çështje në interes të grave apo të komuniteteve.

Ky komision është njëri ndër komisionet me numrin më të madh të takimeve të realizuara dhe projektligjeve të shqyrtuara. Atmosfera e punës ka qenë serioze dhe deputetët kanë qenë çdoherë të përfshirë në diskutime, me përjashtim të deputetit Saša Milosavjević dhe deputetes Duda Balje të cilët kanë qenë më pasiv gjatë mbledhjeve.

2.8 KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI, MJEDIS E PLANIFIKIM HAPËSINOR

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka mbajtur gjithsej 17 mbledhje dhe asnjë dëgjim publik. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2015, këtë vit komisioni ka mbajtur pesë mbledhje më shumë, duke përjashtuar dëgjimet publike që nuk janë realizuar asnjë sikurse këtë sesion. Anëtarë të këtij komisioni kanë qenë të rregullt në pjesëmarrjen në mbledhjet e mbajtura.

Në Planin e Punës për sesionin pranveror është paraparë shqyrtimi i gjashtë projektligjeve, katër prej të cilave në shqyrtim të dytë. Vetëm njëri prej këtyre projektligjeve është përfunduar, por që nuk është proceduar për miratim në seancën plenare për shkak se KBF nuk ka dhënë aprovimin për implikimet buxhetore. Ndërsa, dy projektligje të tjera kanë kaluar në lexim të parë.

Anëtarët e komisionit në shumicën e rasteve nuk kanë qenë të përgatitur për të shqyrtuar projektligjet, për më tepër kanë kërkuar që t'i rekomandojnë seancës miratimin e ligjeve në parim e të cilat nuk janë lexuar fare nga anëtarët e komisionit. Kësisoj është rrezikuar që të vihen në lajthitje deputetët.

Është planifikuar mbikëqyrja e zbatimit të tri ligjeve prej të cilave vetëm njëri është realizuar, ai për Inspektionin Bujqësor. Për raportim janë ftuar Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Memli Krasniqi dhe Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, Ferid Agani, të cilët i janë përgjigjur pozitivisht ftesave. Dy raporte vjetore të organeve të pavarura janë shqyrtuar, ashtu siç ka qenë e paraparë në Planin e Punës.

Në të gjitha takimet e mbajtura, ky komision nuk ka ngritur asnjëherë çështje që janë në interes të komuniteteve dhe çështje që ndërlidhen me gratë.

2.9 KOMISIONI PËR SHËNDETËSI, PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie 14 mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publik. Krahasuar me sesionin pranveror të vitit të kaluar ku komisioni kishte mbajtur 14 mbledhje dhe dy dëgjime publike, del se dinamika e punës ka mbetur pothuajse e njëjtë. Në shumicën e rasteve mbledhjet kanë filluar me vonesë për shkak të vonesave të deputetëve, ndërsa një mbledhje ka dështuar të mbahet për shkak të mungesës së kuorumit.

Në Planin e Punës është paraparë shqyrtimi i gjashtë projektligjeve, prej të cilëve janë shqyrtuar tre. Njëri nga projektligjet është bartur nga viti i kaluar (Projektligji për Shërbimin Mjekësor Emergjent) dhe ka vazhduar të mbetet në procedurë në grup punues për një periudhë prej shtatë muajsh, përkundër që sipas Rregullores kjo periudhë nuk do duhej të zgjaste më shumë se dy muaj. Ashtu siç është paraparë, komisioni ka marrë iniciativën për nismën ligjore për Projektligjin për plotësim ndryshimin e “Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre”, mirëpo ende nuk është përgatitur drafti i këtij projektligji. E planifikuar për këtë sesion ka qenë edhe mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Shëndetësinë. Ky proces nuk ka përfunduar por që komisioni ka filluar me vizita në terren. Në fillim të vitit sipas planifikimit, komisioni ka bërë mbikëqyrjen buxhetore të skemave sociale dhe për këtë ka dorëzuar raportin me rekomandime në Kuvend. Në komision ka raportuar dy herë Ministri i Shëndetësisë Imet Rrahmani dhe një herë Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale Arban Abrashi.

Edhe pse ky komision nuk ka pasur planifikime të mëdha apo dinamike të lartë të punës, çështjet që kanë qenë në fushë-veprimtarinë e komisionit janë shqyrtuar me seriozitet dhe me përkushtim. Zakonisht për të marrë sa më shumë informacione për çështjet e caktuara anëtarët e komisionit janë takuar me anëtarët e kabinetit qeveritarë dhe zyrtarët përgjegjës. Vlen të ceket rasti i specialistëve të papunë, të cilët me rastin e shqyrtimit të Projektligjit për Plotësim Ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e vitit 2016, i janë drejtuar komisionit me kërkesën për sistemimin e tyre dhe buxhetim të pagave. Kërkesa është shqyrtuar menjëherë dhe është ftuar Ministri i Shëndetësisë për të kuptuar se sa ka mundësi për sistemimin e këtyre specialistëve në institucionet shëndetësore. Ky komision në bashkëpunim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, Ministrin e Financave dhe Ministrin e Shëndetësisë kanë arritur që të gjejnë një zgjidhje të përkohshme kësaj çështje.

Një çështje që është shqyrtuar me vëmendje të veçantë ka qenë marrëveshja për kredi ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, për financimin e “Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive”. Kjo marrëveshje është sjellë dy herë në Kuvend. Kundërshtimi ka qenë për shumën prej 500 mijë eurove që i është shtuar marrëveshjes fillestare. Për shkak të rëndësisë së lartë të kësaj kredie, me qëllim që miratimi i kësaj marrëveshje të mos dështojë edhe një herë në seancë, me vendim të Kryesisë së Kuvendit, komisioni ka shqyrtuar më në detaje marrëveshjen dhe janë konsultuar me Ministrin e Shëndetësisë dhe Ministrin e Financave. Pas kësaj, komisioni ka vendosur që së bashku me KBF të bëjnë mbikëqyrjen e shpenzimit të kësaj vlere prej 500 mijë euro, ndërsa marrëveshja është miratuar në seancë plenare.

2.10 KOMISIONI PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE MBIKËQYRJEN E FSK-SË

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FKS-së ka zhvilluar gjithsej 11 takime, prej tyre nëntë mbledhje të rregullta dhe dy dëgjime publike. Nga krahasimi me vitin e kaluar për periudhën e njëjtë, këtë vit komisioni ka pasur dinamikë më të ulët të punës duke mbajtur 10 mbledhje më pak.

Numri i vogël i mbledhjeve të mbajtura të këtij komisioni ka rezultuar me mos përmbyshjen e pjesës më të madhe të Planit të Punës. Shqyrtimi dhe amendamenti i projektligjeve është një nga detyrat kryesore të komisioneve, detyrë të cilën ky komision nuk e ka kryer gjatë këtij sesionin pasi që nuk ka shqyrtuar asnjë nga projektligjet që i ka paraparë.

Në Planin e Punës është paraparë që brenda sesionit pranveror të shqyrtohen gjashtë projektligje, prej të cilave nuk është arritur të shqyrtohet asnjëri. Është shqyrtuar vetë një raport vjetor nga katër raporte vjetore të organeve të pavarura që bien në fushëveprimin e këtij komisioni.

Sa i përket mbikëqyrjes së ekzekutivit, gjegjësisht ministritë e linjës, komisioni i është përmbytur Planit të Punës. Në raportim janë thirrur ministri i FSK-së, Haki Demolli dhe ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Skender Hyseni, të cilët i janë përgjigjur pozitivisht ftesës. Komisioni nuk ka paraparë të mbikëqyrë zbatimin e asnjë ligji.

Vetëm një herë janë ngritur çështje që kanë të bëjnë për interesat e komuniteteve, gjegjësisht komunitetin boshnjak nga deputeti Cerim Bajrami. Ndërsa çështjet që kanë të bëjnë me interesat e grave nuk janë diskutuar asnjëherë në të gjitha mbledhjet e mbajtura.

Për dallim nga shumica e komisioneve që mbledhjet i kanë filluar gjithmonë me vonesë, ky komision është ndër të paktë që e kanë respektuar orarin e caktuar për fillimin e mbledhjeve.

2.11 KOMISIONI PËR ADMINISTRATË PUBLIKE, QEVERISJE LOKALE DHE MEDIA

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje të rregullta, kurse dëgjime publike nuk ka mbajtur fare. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka rënie të dukshme të takimeve të mbajtura për 13 më pak këtë sesion.

Ky komisioni në Planin e tij të Punës ka paraparë shqyrtimin në parim të katër projektligjeve, ndonëse janë shqyrtuar vetëm dy prej tyre. Në shqyrtim të dytë janë paraparë të jenë katër projektligje, kurse është shqyrtuar vetëm njëri. Fokusi kryesor i këtij komisioni ka qenë Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për RTK-në dhe Projektligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rreth të cilëve janë zhvilluar pothuajse të gjitha mbledhjet (në gjashtë nga nëntë mbledhjet është diskutuar për këto dy projektligje). Gjatë këtij sesioni i vetmi projektligj që ka kaluar në shqyrtim të dytë është Projektligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili është dërguar për shqyrtim përfundimtar në seancën plenare.

Në bazë të Planit të Punës është paraparë edhe mbikëqyrja e zbatimit të katër ligjeve, por nuk është realizuar asnjë. Gjithashtu, është paraparë që të ftohet për raportim Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal për Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave, mirëpo komisioni nuk e ka ftuar. Nga pesë raporte të organeve të pavarura sa janë paraparë për shqyrtim këtë sesion, katër prej tyre janë shqyrtuar dhe janë proceduar për miratim në Kuvend.

Ky komision nuk ka ngritur asnjë çështje që lidhet me interesat e komuniteteve dhe të grave.

2.12 KOMISIONI PËR MBIKËQYRJE TË FINANCAVE PUBLIKE

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) ka mbajtur gjithsej 12 takime, prej tyre 11 mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publik. Numri i takimeve të mbajtura nga ky komision në vitin 2016, të sesionit pranveror është i njëjtë me vitin e kaluar për periudhën e njëjtë.

Vetëm një projektligj është paraparë për shqyrtim, i cili është bartur nga viti 2015. Nuk është paraparë mbikëqyrja e zbatimit ligjeve, e po ashtu nuk është ftuar për raportim asnjë anëtar i kabinetit qeveritar. Për dallim prej viteve të kaluara kur numri i ministrave që kanë raportuar në këtë komision lidhur me menaxhimin e shpenzimeve publike ka qenë dukshëm më i madh.

Nga të gjitha takimet e mbajtura ky komisioni nuk ka ngritur asnjëherë çështje që janë në interes të komuniteteve apo të grave. Komisioni ka pasur për fokus shqyrtimin e raporteve të Auditorit të Përgjithshëm për organizatat buxhetore që i raportojnë Kuvendit. Nga 93 raporte, ku prej tyre 37 janë auditime të komunave që janë dorëzuar në këtë komision nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë shqyrtuar vetëm tri prej tyre. KMFP ka shqyrtuar raportet kthyes me rekomandime të 10 organizatave buxhetore për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga KMFP.

Komisioni shpeshherë nuk ka mbajtur as minimumin prej dy mbledhjeve brenda muajit që parashihen me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Si rezultat i mbledhjeve të rralla ka ardhur deri te një performancë e dobët dhe mos përbushje të planifikimeve sado modeste që kanë qenë ato.



2.13 KOMISIONI PËR MBIKËQYRJEN E AGJENCIONIT KOSOVAR PËR INTELIGJENCË

Ky komision ka mbajtur gjithsej shtatë mbledhje të rregullta. Numri i mbledhjeve të mbajtura nga ky komision për këtë sesion është më i vogël edhe në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ku janë mbajtur 12 mbledhje.

Të gjitha takimet e këtij komisioni janë mbajtur me dyer të mbyllura dhe procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura nuk janë publike, përveç mbledhjes së fundit ku është diskutuar për Planin e Punës të këtij komisioni, plan ky i cili nuk është publik. Për këtë arsye nuk ka qenë i mundur monitorimi i performancës së deputetëve që janë pjesë e këtij komisioni e as e komisionit në tërësi. Megjithatë pjesëmarrja e deputetëve është evidentuar pa filluar mbledhja dhe janë verifikuar nga të dhënat e ueb faqes së Kuvendit të Kosovës.

Në bazë të pikave të rendit të ditës për secilën mbledhje të mbajtur, të cilat ka qenë të publikuar në ueb-faqen e Kuvendit kuptojmë që ky komision nuk ka shqyrtuar asnjë projektligj. Po ashtu nuk ka mbikëqyrë zbatimin e asnjë ligji si dhe nuk ka ftuar për raportim asnjë ministër. Mirëpo, kanë qenë të ftuar disa herë drejtori i AKI-së Agron Selimaj dhe Inspektori i Përgjithshëm, Shkelzen Sopjani.

miratuar në Kuvend. Ndërsa projektligji tjetër i paraparë për shqyrtim ka kaluar vetëm në shqyrtim të parë ani pse shqyrtimi dhe procedim i tij në Kuvend është paraparë të ndodhë në muajin prill. Pa u shqyrtuar ka edhe mbetur Projektligji për plotësim – ndryshimin e Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë. Ky komisioni po ashtu ka shqyrtuar Raportin Vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015, i vetmi raport i planifikuar për shqyrtim në këtë sesion.

Është bërë mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje si dhe janë shqyrtuar dy peticione. Ky komision është ndër komisionet që më së shumti ka ngritur çështje që janë në interes të komuniteteve dhe grave, kjo edhe për shkak që këto çështje bien në fushëveprim të këtij komisioni. Nga nëntë mbledhje sa janë mbajtur, dy herë janë ngritur çështje që lidhen me gratë – më konkretisht është diskutuar për dhunën në familje ndërsa tri herë janë diskutuar çështje në interes të komuniteteve, në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Numri shumë i vogël i mbledhjeve të mbajtura ka ndikuar edhe në mos realizimin e planit të punës së paraparë për këtë sesion. Një prej pikave të rëndësishme në planin e punës ka qenë edhe shqyrtimi i listës së kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit, e propozuar nga Avokati i Popullit. Avokati i Popullit kishte propozuar një listë të kandidatëve në të cilën nuk përfshihej një zëvendës nga komuniteti serb, meqë rast komisioni e ka kthyer mbrapa këtë listë. Deri më tani Avokati i Popullit nuk ka sjellë në Kuvend listën e re edhe pse ky institucion ka mbetur pa zëvendës që 11 muaj.

2.14 KOMISIONI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, BARAZI GJINORE, PËR PERSONA TË PAGJETUR DHE PETICIONE

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione ka realizuar gjithsej 11 takime, prej tyre 10 mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publik. Nga krahasimi me sesionin pranveror të vitit 2015 janë mbajtur 11 takime më pak. Anëtarët e këtij komisioni, sa i përket pjesëmarrjes kanë qenë më të rregullt në krahasim me komisionet tjera.

Komisioni ka shqyrtuar dy projektligje të cilat i ka paraparë në Planin e Punës, një projektligj që është bartur nga 2015 dhe një të vitit 2016. Projektligji për Paraplegjikët dhe Tetraplegjikët që është bartur nga viti 2015 tashmë është

2.15 KOMISIONI PARLAMENTAR PËR STABILIZIM ASOCIIM

Me të hyrë në fuqi Marrëveshja për Stabilizim - Asociim ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, Kuvendi i Kosovës si një nga akterët kryesor institucional në zbatimin e kësaj marrëveshje dhe në përputhje me PKZMSA-në (Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim – Asociim) ka themeluar Komisionin Parlamentar për Stabilizim Asociim që është organi i parë i përbashkët me BE-në.

Mënyra e funksionimit të këtij komisioni është e rregulluar me Rregulloren e Punës së Komisionit të hartuar dhe miratuar nga vet komisioni si dhe në përputhje me nenin 132 të MSA-së. Në takimet zyrtare, anëtarët nga të dyja komisionet (KPSA dhe komisionit të BE-së) kanë për detyrë të informojnë njëri – tjetrin për prioritetet respektive dhe





për nivelin e implementimit të marrëveshjeve të arritura. Në bazë të kësaj, ata mund të nxjerrin rekomandime për të dyja palët e përfshira në marrëveshje. Po ashtu monitorojnë progresin e arritur të Kosovës në këtë rast, për hyrjen në BE. Numri i takimeve nuk është i përcaktuar, kjo mund të vendoset në koordinim mes të dyja palëve mirëpo është e obliguar që komisioni të takohet të paktën një herë në vit.

Në përbërje të këtij komisioni parlamentar të themeluar nga Kuvendi i Kosovës janë të përfaqësuar deputetët të të gjitha subjekteve politike që pasqyrojnë përbërjen e Kuvendit. Ky komision numëron 15 anëtarë gjithsej, aq sa ka edhe komisioni nga BE-ja.

Që nga muaji prill i këtij viti, kur edhe është themeluar ky komision, janë mbajtur gjithsej pesë takime, ku një nga to kanë qenë takim i përbashkët me Komisionin Parlamentar për MSA-në nga BE-ja. Katër takimet e para kanë pasur karakter informues e përgatitor për mbledhjen e përbashkët me përfaqësuesit e komisionit parlamentar nga BE-ja. Për këtë arsye edhe pjesëmarrja e deputetëve - anëtarë të këtij komisioni nuk ka qenë shumë e rregullt. Mirëpo në takimin zyrtar, të pranishëm kanë qenë të gjithë anëtarët e këtij komisioni, të të gjitha grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës.

Në takimet e mbajtura me datë 16 dhe 17 maj 2016, komisioni parlamentar për MSA-në nga parlamenti i Kosovës dhe ai Evropian kanë diskutuar për gjashtë tema². Pas diskutimeve janë dhënë dhe miratuar rekomandimet mbi çështjet e diskutuara. Ndërsa takimi i radhës mes dy palëve do të mbahet në muajin nëntor të këtij vitit në Bruksel.

2.16 NËN-KOMISIONI PËR MANDATE, IMUNITETE DHE RREGULLOREN E KUVENDIT

Nën-komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit ka mbajtur vetëm dy takime. Në të dyja mbledhjet fokusi ka qenë në shqyrtimin e Projektligjit për Kuvendin, mirëpo procedurat për shqyrtimin e këtij projektligji nuk kanë nisur ende.

²Gjendja e marrëdhënieve BE-Kosovë; Dialogu politik dhe funksionimi i institucioneve demokratike; Marrëdhëniet me fqinjët dhe bashkëpunimi rajonal, duke përfshirë dialogun e lehtësuar mes Kosovës dhe Serbisë nga BE-ja; Zhvillimi ekonomik në lidhje me sundimin e ligjit, përfshirë luftën kundër korrupsionit; Fuqizimi i Rinisë dhe Antiradikalizm; Dialogun Social-Shëndetësia dhe Arsimit; Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut veçanërisht atyre me nevoja të veçanta dhe Pluralizimi i Mediave.





3. MBARËVAJTJA E SEANCAVE PARLAMENTARE


Kuvendi i Kosovës në sesionin pranveror të vitit 2016 ka pësuar rënie sa i përket mbajtjes së seancave krahasuar me periudhat e më hershme. Bojkotimi i punimeve të Kuvendit nga ana e përfaqësuesve të subjekteve politike opozitare,³ përveç që ka ndikuar negativisht në efikasitetin e Kuvendit e ka pamundësuar sigurimin e kuorumit të nevojshëm prej 61 deputetëve për të mbajtur seanca. Përkundër që partnerët e koalicionit qeverisës kanë mbi dy të tretat e deputetëve në Kuvend, disa herë radhazi seancat kanë dështuar të mbahen pasi që nuk kishte kuorum.

Bojkotimi i seancave nga përfaqësuesit e opozitës kishte filluar në muajin shkurt, pas zgjedhjes së Presidentit të ri të vendit, deri në rikthimin e LVV-së në fillim të muajit qershor. AAK dhe Nisma kanë vazhduar bojkotin deri në fund të sesionit pranveror.

SEANCAT PLENARE – Janë mbajtur 14 seanca plenare, ndërsa nëntë herë seancat kanë vazhduar në një ditë tjetër. Kjo paraqet një rënie në krahasim me sesionin e kaluar, gjatë të cilit sesion Kuvendi kishte mbajtur 23 seanca plenare apo nëntë më shumë. Numri i vogël i seancave ka ndikuar në produktivitetin e punës së Kuvendit. Nga

³ Bojkotim i punimeve të Kuvendit ka ardhur si formë e shprehjes së kundërshtimit të Marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe; si dhe të Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

► FIGURA 2. Krahasimi i seancave për sesionin pranveror 2015-2016





► **TABELA 2. Mungesat e të gjithë deputetëve në seanca sipas muajve**

Muajt:	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Seancat:	3	4	2	2	3	4	2	1
Mungesat:	107	133	81	114	80	130	60	14

fundi i sesionit, pikat e rendit të ditës së seancave kanë filluar të shtohen, gjë që ka ngarkuar agjendën dhe ka ndikuar negativisht në përqendrimin e deputetëve për të trajtuar me kujdes të gjitha pikat.

Seancat e jashtëzakonshme – Këtë sesion Kuvendi ka mbajtur dy seanca të jashtëzakonshme, dy më pak nga sa janë mbajtur sesionin e kaluar pranveror. Në seancën e parë të jashtëzakonshme është zgjedhur Presidentit i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, seancë kjo e shoqëruar me hedhje të gazit lotsjellës nga opozita dhe largim me forcë nga salla e Kuvendit të këtyre të fundit. Ndërsa seanca e dytë e jashtëzakonshme është mbajtur për shqyrtim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për vazhdimin e mandatit të misionit të BE-së për sundimin e ligjit, EULEX, projektligj ky i cili është proceduar në Kuvend me procedurë të përshpejtuar.

SEANCAT SOLEMNE - Vetëm dy seanca solemne janë mbajtur në këtë sesion, për dallim nga gjashtë sa ishin mbajtur në sesionin e kaluar. E para është mbajtur me rastin e betimit të presidentit, ndërsa çështja e dytë për të cilën është mbajtur seancë solemne ka qenë adresimi


i Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, Federica Mogherini, drejtuar deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Deputetët e subjekteve politike opozitare bojkotuan seancën e betimit të Presidentit ndërsa ishin të pranishëm në fjalimin e Mogherinit.

PJESËMARRJA E DEPUTETËVE NË SEANCA-

Pjesëmarrja e deputetëve në seancat e mbajtura këtë sesion nuk ka qenë e rregullt. Përkundër numrit të vogël të seancave, deputetët kanë munguar plot 719 herë. Ky numër i madh i mungesave është kryesisht si rezultat i bojkotit që subjektet politike opozitare i'a bënë punimeve të Kuvendit që nga muaji shkurt. Mesatarisht secili nga 120 deputetët ka munguar rreth 6 herë në sesionin pranveror.

Sa i përket mungesave të deputetëve sipas grupeve parlamentare del se grupi parlamentar me më së shumti mungesa është grupi parlamentar i LVV-së me gjithsej 203 mungesa, pasuar nga AAK me 152 mungesa, NISMA me 110, LDK me 77, PDK me 71, LS me 51, deputetët pa grup parlamentar me 46 mungesa dhe grupi parlamentar 6+ me 9 mungesa.

► **FIGURA 3. Mungesat e deputetëve në seanca sipas grupeve parlamentare**





Përrjashtuar deputetët e opozitës, deputetët me më së shumti mungesa në seanca janë: Jelena Bontiç (10), Ramiz Kelmendi (9), Margarita Kadriu-Ukelli (8), Adem Hodža (7) dhe Slobodan Petroviç (7).

Në anën tjetër, deputetët më të rregullt të këtij sesioni, të cilët nuk kanë munguar asnjëherë nga marrja e mandatit janë: Abdyl Ymeri, Agim Ademaj, Ali Sadriu, Bislim Zogaj, Fikrim Damka, Flora Brovina, Kujtim Paqaku, Labinotë Demi-Murtezi, Melihate Tërmmkolli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Sabri Hamiti, Xhevahire Izmaku dhe Zenun Pajaziti.

Kuvendi këtë sesion është shoqëruar edhe me shumë lëvizje të deputetëve qoftë brenda grupeve parlamentare qoftë edhe me dorëheqje nga mandati i deputetit. Dy deputetë, Ilir Deda nga LVV dhe Ramiz Kelmendi nga PDK i janë shtuar grupit të deputetëve të pavarur, ndërsa deputetja Donika Kadaj – Bujupi ka kaluar nga grupi parlamentar i AAK-së në atë të LVV-së. Ndërsa shtatë deputetë për arsye të ndryshme kanë dorëzuar mandatet e deputetit. Nga PDK mandatet i dorëzuan dy deputetë, Azem Syla dhe Enver Hoxhaj, nga LDK dy deputete, Teuta Sahatqija dhe Alma Lama, si dhe Besnik Bislimi nga LVV dhe Ramush Haradinaj nga AAK.



4. PËRMBUSHJA E AGJENDËS LEGJISLATIVE


Planifikimi është një nga parakushtet kryesore për kryerjen e punëve. Në vitin 2016, Kuvendi i ka zhvilluar punimet pa miratuar një plan të punës, siç parashihet me Rregulloren. Në anën tjetër Qeveria në programin e vet legjislativ kishte planifikuar të dorëzonte në Kuvend 87 projektligje, prej të cilave deri në fund të sesionit pranveror i dorëzoi 23. Ndërkohë, komisionet kanë hartuar planet e punës bazuar në Programin Legjislativ të Qeverisë, duke i përfshirë edhe projektligje tjera që i kanë konsideruar të rëndësishme, përfshirë edhe 24 projektligje që janë bartura nga viti i kaluar. Gjithsej programi legjislativ i Kuvendit ka përbajtur 135 projektligje. Nga këto projektligje, në sesion pranveror janë miratuar 35 ligje (25.9%), në procedurë të komisioneve parlamentare kanë mbetur 20 projektligje (14.8%) përdërisa 80 (59%) të tjera nuk janë dorëzuar ende në Kuvend nga Qeveria. Tetë nga ligjet e miratuara janë plotësisht ndryshim i ligjeve ekzistuese ndërsa 27 janë ligje të reja. Nga tërësia e ligjeve të miratuara nëntë janë ligje për ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare, nga të cilat tetë janë mar-

rëveshje financiare. Krahasuar me sesionin e kaluar pranveror, këtë vit Kuvendi ka miratuar gjashtë ligje më shumë.

Të kategorizuara sipas sektorëve më së shumti ligje janë miratuar nga financat 13, drejtësia 5, energjia 4, anti-korrupsioni 2, komunikacioni 2, shëndetësia 2, ekonomia, sociale 1, metalurgjia 1, punë të jashtme 1, të drejtat e njeriut 1, administratë 1 dhe siguri 1.

> FIGURA 5. Miratimi i ligjeve sipas sektorëve

Sektori	Numri i ligjeve
Ekonomi	1
Sociale	1
Metalurgji	1
Punë të Jashtme	1
Të Drejta të Njeriut	1
Administratë	1
Siguri	1
Anti Korrupcion	2
Komunikacion	2
Shëndetësi	2
Energji	4
Drejtësi	5
Financa	13





Kuvendi ka vazhduar me praktikën e shqyrtimit të projektligjeve në procedurë të përsheptuar, ku vetëm gjatë këtyre muajve, gjashtë nga ligjet e miratuara janë shqyrtuar me procedurë të përsheptuar. Vlen të përmendet rasti i Ligjit për plotësim ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e vitit 2016. Për një ligj të rëndësishëm së tillë procesi i shqyrtimit përveç që me procedurë të përsheptuar ka qenë dhe jo transparent, pasi që mbledhja e KBF-së në të cilën është bërë shqyrtimi i këtij projektligji është mbajtur me dyer të mbyllura.

Sfiduese për Kuvendin vazhdon të mbetet iniciimi i legjisllacionit. Këtë sesion Kuvendi ka ndërmarrë vetëm një nismë ligjore, atë e ka bërë Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe dy projektligje⁴ që kanë qenë iniciativë ligjore e Kuvendit, të cilat janë bartur nga viti 2015. Duhet theksuar se një projektligj⁵ tjetër që është bartur nga viti i kaluar ka qenë iniciativë qytetare. Të gjitha projektligjet tjera të shqyrtuara janë të sponsorizuara nga Qeveria.

Disa dukuri që e kanë përcjellë punën e Kuvendit këtë sesion kanë qenë: kthimi i projektligjeve për shqyrtim të tretë, mosmiratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare si dhe mos votimi i deputetëve përkundër pranisë së tyre në sallë. Dy projektligje kanë shkuar për lexim të tretë në Kuvend. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare është përcjellë me mospajtime të mëdha ndërmjet deputetëve. Dy nga marrëveshjet⁶ e sjella për ratifikim nga Qeveria, pasi ishin refuzuar në fillimi prej deputetëve janë ri-sjellë në Kuvend. Një marrëveshje⁷ tjetër ndërkombëtare nuk është ratifikuar pasi nuk mori numrin e nevojshëm të votave të deputetëve.

Ndërsa, një projektligj i një rëndësie të veçantë por edhe shumë i debatuar gjatë këtij sesiioni ka qenë Projektligji për Investime Strategjike. Për shkak të mospajtit të deputetëve të koalicionit qeverisës rreth një amendamenti të këtij projektligji i cili rregullon mënyrën e bartjes së pronës publike tek investitorët strategjik, nuk është miratuar. Me rastin e votimit në sallë kanë qenë të pranishëm 77 deputetë prej të cilëve vetëm 44 deputetë kanë marrë pjesë në votim (40 për, 1 kundër dhe 3 abstenime), numër ky i pamjaftueshëm i votave për ta konsideruar të vlefshëm votimin, pasi që nevojitet që të votojnë të paktën 61 deputetë në mënyrë që votimi të cilësohet i vlefshëm. Për këtë arsye, statusi i këtij projektligji ka mbetur pezull.

4 Ligji nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtari Minerare (I miratuar); si dhe Projektligji për zonën e rrezikuar të Obiliqit dhe rreth tij (që është ende në procedurë).

5 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar me ligjet 03/L-221, 04/L-116, 04/L-194.,05/L-063

6 Marrëveshja për Hua për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e Rehabilitimit të Rrugës Hekurudhore 10; si dhe Marrëveshja e kredisë për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

7 Marrëveshja përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor



5. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE


Mbikëqyrja e ekzekutivit nga Kuvendi bëhet përmes mekanizmave të ndryshëm të përcaktuara në Rregullore. Këto mekanizma përfshijnë pyetjet parlamentare me gojë dhe me shkrim, interpelancat, raportet e zbatimit të ligjeve dhe debatet parlamentare për të diskutuar për politikat qeverisëse. Gjatë periudhës raportuese Kuvendi ka shfrytëzuar shumë pak këto masa duke shënuar dobësim të rolit të vet mbikëqyrës.

5.1 PYETJET PARLAMENTARE

Pyetjet parlamentare shërbejnë si mjet për Kuvendin për të kontrolluar punën dhe efektivitetin e ekzekutivit dhe dikastereve të tij. Sipas Rregullores së Kuvendit, rendi i ditës në çdo mbledhje duhet të parasheh 60 minuta kohë për pyetje parlamentare, ku secili deputet ka të drejtë të parashtrij më së shumti dy pyetje,⁸ të cilat nuk mund të zgjasin më shumë se dy minuta. Më tutje, deputeti ka të drejtë të parashtrijë edhe një pyetje ndihmëse e cila nuk duhet të zgjasë më shumë se një minut.⁹ Në rast se pyetja nuk merr përgjigje brenda dy seancave pasuese, atëherë pyetja publikohet në Revistën e Kuvendit dhe në ueb faqen zyrtare të Kuvendit.

Për dallim nga sesioni i kaluar pranveror, ku u parashtruan gjithsej 201 pyetje parlamentare, këtë sesion Kuvendi i Kosovës është shquar për numër shumë të vogël të pyetjeve parlamentare drejtuar kabinetit qeveritar, me vetëm 83 pyetje parlamentare. Një numër kaq i vogël i pyetjeve parlamentare vjen kryesisht si rezultat i bojkotit të opozitës, por edhe numrit relativisht të vogël të seancave të mbajtura. Kjo e dhënë tregon tendenca të zbehjes së rolit mbikëqyrës të Kuvendit. Nga gjithsej 83 pyetje parlamentare të parashtruara këtë sesion, përgjigje është marrë në 45 prej tyre.

⁸ Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 45, pika 1.
⁹ Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 45, pika 2.



Ngjashëm sikur në sesionin e vitit të kaluar edhe në sesionin e sivjetmë pyetjet parlamentare drejtuar kabinetit qeveritar kanë ardhur kryesisht nga opozita, më konkretisht nga LVV-ja, e cila ka parashtruar mbi 50% të numrit të përgjithshëm të pyetjeve parlamentare (41), pasuar nga grupi parlamentar i PDK-së (33), LDK-së (7), SL-së (1) dhe 6+ (1).

Cak i adresimit të pyetjeve parlamentare kanë qenë ministrat nga radhët e LDK-së, duke përfshirë kryeministrin, ndaj të cilëve janë parashtruar 59 pyetje parlamentare (71%). Më së shumti pyetje i janë parashtruar kryeministrit Isa Mustafa (17), ministrave Arsim Bajrami (15), Arban Abrashi (10), Avdullah Hoti (7) dhe Lutfi Zharku (7). Shumica dërrmuese e këtyre pyetjeve janë parashtruar kryesisht nga deputetët e LVV-së (27) dhe PDK-së (24). Nga këto të dhëna, del se subjekti i pothuajse të gjitha pyetjeve parlamentare nga deputetët e PDK-së, janë ministrat nga radhët e LDK-së. Për dallim nga kolegët e tyre, deputetët e LDK-së ia kanë drejtuar pothuajse të gjitha pyetjet (6) anëtarëve të ekzekutivit që vijnë po nga radhët e subjektit politik që i përkasin ata vet, LDK-së.



Ministri/ja	Subjekti politik	Pyetje	Përgjigje	Nuk është përgjigjur	Përgjigjet në për qindje %	Përqindja e pyetjeve drejtuar ministrit/res
Avdullah Hoti	LDK	7	7	0	100%	8%
Arsim Bajrami	PDK	15	9	6	60%	18%
Enver Hoxhaj	PDK	2	1	1	50%	2%
Lutfi Zharku	LDK	7	7	0	100%	8%
Isa Mustafa	LDK	17	3	14	18%	20%
Edita Tahiri	PDK	1	1	0	100%	1%
Imet Rrahmani	LDK	5	3	2	60%	6%
Hajredin Kuçi	PDK	3	0	3	0%	4%
Kujtim Shala	LDK	5	0	5	0%	6%
Arban Abrashi	LDK	10	8	2	80%	12%
Skender Hyseni	LDK	7	4	3	57%	8%
Dalibor Jevtic	SL	1	1	0	100%	1%
Lubomir Maric	SL	1	0	1	0%	1%
Hykmete Bajrami	LDK	1	0	1	0%	1%
Dhurata Hoxha	PDK	1	1	0	100%	1%

Në raste të caktuara, deputetët kanë parashtruar pyetje të cilat nuk kanë të bëjnë me fushëveprimtarinë e ministrave.

Nga 21 ministra të Qeverisë së Kosovës, vetëm ndaj 15¹⁰ prej tyre janë parashtruar pyetje parlamentare. Ministrat me më së shumti përgjigje janë Arsim Bajrami, me 9 përgjigje nga gjithsej 15 pyetje të adresuara ndaj tij, Arban Abrashi, me 8 përgjigje nga 10 pyetje. Kurse më së paku përgjigje ka dhënë kryeministri Isa Mustafa, me vetëm 3 përgjigje nga gjithsej 17 pyetje.

Në përgjithësi më së shumti përgjigje ka marrë grupi parlamentar i PDK-së (25), pasuar nga LVV (13), LDK (5), SL (1) dhe 6+ (1). Një pjesë e konsiderueshme e përgjigjeve, e në disa raste edhe pyetjeve, nuk ishin përmbajtjesore, sepse kryesisht trajtonin çështje të vogla teknike. Në raste të caktuara, pyetjet ishin edhe promovuese për ministrat, sidomos në pyetjet drejtuar ministrave të PDK-së nga deputetët e grupit parlamentar të PDK-së.


10 Duke përfshirë edhe ish-ministrat të cilët nuk janë më në atë post

Këtë sesion pyetje parlamentare kanë parashtruar vetëm 24 deputetë, që i bijnë se 96 deputetë nuk kanë parashtruar pyetje fare. Prej 24 deputetëve që kanë parashtruar pyetje parlamentare, 11 janë nga PDK, 9 nga LVV, 2 nga LDK dhe nga 1 pyetje SL dhe 6+. Deputeti me më së shumti pyetje parlamentare është Ismajl Kurteshi (22), kurse deputetët me më së paku pyetje (1) janë: Bislim Zogaj, Danush Ademi, Mytahir Haskuka, Rafet Rama, Sala Berisha-Shala, Slavko Simič dhe Shqipe Pantina.

Sa i përket sektorëve në të cilët janë parashtruar pyetjet parlamentare, fokusi më i madh i deputetëve ka qenë në sektorin e punëve të brendshme dhe arsimit, ku janë parashtruar më së shumti pyetje parlamentare, gjithsej 14, prej të cilave janë marrë vetëm 5 përgjigje respektivisht 9. Sektorët tjerë me më së shumti pyetje parlamentare janë sektori i çështjeve sociale me 11 pyetje dhe 9 përgjigje, infrastruktura me 7 pyetje dhe 7 përgjigje, financat me 7 pyetje dhe 6 përgjigje, shëndetësia me 6 pyetje dhe 3 përgjigje, drejtësia me 5 pyetje dhe një përgjigje, administrata



► FIGURA 7. Pyetjet parlamentare sipas grupeve parlamentare



► TABELA 3. LISTA E DEPUTETËVE QË KANË PARASHTRUAR PYETJE, SIPAS GRUPEVE PARLAMENTARE

Grupi Parlamentar	Deputeti/ja	Numri i pyetjeve	
PDK	Mexhide Mjaku-Topalli	7	
	Abdyl Ymeri	5	
	Raif Qela	4	
	Salihe Mustafa	3	
	Bekim Haxhiu	3	
	Blerta Deliu-Kodra	2	
	Ganimete Musliu	4	
	Labinotë Demi-Murtezi	2	
	Bislim Zogaj	1	
	Rafet Rama	1	
	Sala Berisha-Shala	1	
	LDK	Alma Lama	5
		Njomza Emini	2
LVW	Ismajl Kurteshi	22	
	Besa Baftiu	4	
	Faton Topalli	4	
	Albulena Haxhiu	3	
	Donika Kadaj-Bujupi	2	
	Puhie Demaku	2	
	Salih Salihu	2	
	Mytaher Haskuka	1	
	Shqipe Pantina	1	
6+	Danush Ademi	1	
LS	Slavko Simić	1	

► FIGURA 8. Sektorët sipas të cilëve janë parashtruar pyetjet parlamentare



► **TABELA 4. PYETJET PARLAMENTARE TË NDARA SIPAS GJINISË**

Top 3 temat e grave deputete	Top 3 temat e burrave deputet
1 Arsim	1 Punë të Brendshme
2 Sociale	2 Arsim
3 Financa	3 Infrastrukturë

me 4 pyetje dhe 2 përgjigje ekonomia me 2 pyetje dhe 2 përgjigje, punët e jashtme me 2 pyetje dhe 1 përgjigje, sporti, kultura me 2 pyetje por asnjë përgjigje, siguria me 2 pyetje dhe një përgjigje dhe të drejtat e njeriut me nga 1 pyetje dhe 1 përgjigje. Sektorët me më së paku pyetje dhe përgjigje, pa përfshirë sektorët ku nuk është parashtruar asnjë pyetje parlamentare, janë sektorët e metalurgjisë, tregtisë dhe bujqësisë, në të cilët është parashtruar vetëm nga 1 pyetje por nuk është marrë përgjigje në asnjërën prej tyre.

Pyetjet e deputetëve të PDK-së kanë qenë të fokusuar më shumë në sektorin e arsimit (7) dhe çështjeve sociale (6), pyetjet e LDK-së në punë të brendshme (2), të LVV-së po ashtu në punë të brendshme (9) dhe arsimit (6), kurse ato të SL-së dhe 6+ në sociale (1), respektivisht infrastrukturë (1).

Në aspektin gjinor, pyetjet parlamentare shpërfaqin një dominim më të madh të deputetëve burra, të cilët prijnë në parashtrimin e pyetjeve parlamentare me 54% të numrit të përgjithshëm të pyetjeve (45), kurse gratë me 46% të totalit të pyetjeve (38). Kjo mbase është e pritshëm për shkak të numrit më të madh të deputetëve burra të përfaqësuar në Kuvend.

Pyetjet e grave deputete janë të fokusuar më shumë në çështjet e arsimit (7), sociale (7), financave (6) dhe shëndetësisë (5). Kurse, pyetjet e deputetëve burra janë më shumë të fokusuar në punët e brendshme (12), arsimin (7) dhe infrastrukturën (5).

5.2 INTERPELANCAT

Një nga format e ushtrimit të funksionit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj Qeverisë janë edhe interpelancat parlamentare. Janë iniciuar procedurat për thirrjen e dy interpelancave, por që asnjëra prej tyre nuk është mbajtur. Të dy interpelancat janë drejtuar ndaj kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa dhe që të dyja janë iniciuar nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje.

Interpelanca e parë është bërë me kërkesë të deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 7 deputetë të tjerë, në lidhje me Kodin Telefonik Shtetëror të Republikës së Kosovës. Ndërsa interpelanca e dytë është bërë me kërkesë të deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 10 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës.


Me kërkesë të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje që njëherit edhe ka inicuar këto dy interpelanca, janë tërhequr nga rendi i ditës. Tërheqja është bërë me qëllim që të kalohet më shpejtë në pikën tjetër të rendit të ditës të asaj seanca ku ishte planifikuar të bëhet shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

5.3 MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË LIGJEVE

Që nga konstituimi i Kuvendit janë miratuar 652 ligje prej të cilave në fuqi janë 408. Zbatimi i ligjeve në praktikë vazhdon të cilësohet problematik. Komisionet parlamentare kanë për detyrë të mbikëqyrin zbatimin e ligjeve, dhe të hartojnë raporte me rekomandime të cilat i dërgohen Kuvendit për shqyrtim¹¹.

Në sesionin pranveror 11 nga 15 komisionet parlamentare kanë paraparë mbikëqyrjen e zbatimit të 23 ligjeve. Nga numri i përgjithshëm i ligjeve të planifikuara të mbikëqyrën, vetëm për 5 është arritur të dorëzohen raportet në Kuvend kurse në procedurë të mbikëqyrjes kanë mbetur edhe shtatë ligje të tjera.¹² Ndërsa, ka mbetur pa u monitoruar zbatimi i 11 ligjeve të parapara në planet e punës. Vetëm

11 Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 73, pika 1.
12 Ligjet e mbetura në procedurë të mbikëqyrjes janë: Komisioni për Buxhet dhe Financa (1), Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale (1), Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (1), Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e AKK-së (2) dhe Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Zhvillim Rural (2).



> FIGURA 6.
Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve 2016

pesë komisione¹³ kanë arritur t'i mbikëqyrin ligjet e parapara në planet e punës. Ky numër i madh i ligjeve të mbetura pa u mbikëqyrrur tregon se komisionet nuk kanë arritur t'i përmbushin obligimet e parapara.

5.4 MBIKËQYRJA E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA

Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura të themeluara nga Kuvendi¹⁴ vazhdon të jetë problematike për organin më të lartë legjislativ. Shqyrtimi i raporteve vjetore të punës së institucioneve të pavarura është mekanizmi i vetëm me të cilën Kuvendi mban nën mbikëqyrje dhe llogaridhënës këto institucione.

Komisionet parlamentare si trupa punues të Kuvendit, shqyrtojnë raportet vjetore të institucioneve të pavarur që bien në fushëveprimin e tyre dhe të njëjtit i procedojnë në

¹³ Komisioni për Integritet Evropian – një ligj të monitoruar nga dy sa janë paraparë në planin e punës së këtij komisioni; Ligji i monitoruar është Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Vepër Penale; Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim – një ligj të monitoruar nga tri ligje të parapara. Ligji për Shërbyesit Civil; Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport – një ligj i monitoruar nga dy sa janë paraparë të monitorohen. Ligji i monitoruar është Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës; Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor – një ligj i monitoruar nga dy të paraparë. Ligji i monitoruar nga ky komision është Ligji për Inspektionin Bujqësor; Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione – një ligj të monitoruar i cili ka qenë i vetmi ligj i paraparë të monitorohet. Ligji i monitoruar është Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

¹⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 142, pika 1.

seancë plenare për miratim. Në lidhje me këtë duhet theksuar se edhe në rastet kur Kuvendi nuk i miraton raportet e institucioneve të pavarura, ato nuk sanksionohen për shkak se legjislacioni i aplikueshëm nuk parasheh ndonjë procedurë apo masë ndëshkimore për rastet e tilla.

Nga gjithsej 15 komisione, 7 prej tyre kanë shqyrtuar raportet vjetore të organeve të pavarura, kurse gjithsej janë shqyrtuar 20 raporte vjetore të këtyre institucioneve për vitin paraprak. Ndërsa Komisioni për Buxhet dhe Financa përveç shqyrtimit të raporteve vjetore të linjës ka shqyrtuar në aspektin financiar të gjitha raportet tjera të shqyrtuara paraprakisht nga komisionet funksionale.

Kuvendi i Kosovës deri më tani ka themeluar gjithsej 36 institucione të pavarura¹⁵ të cilat dallojnë për nga mënyra e funksionimit. Nga këto 36 institucione të pavarura, 29 prej tyre kanë bordin si të vetmin organ me kompetenca ekzekutive, përdërisa shtatë organe të tjera mund të funksionojnë edhe pa bord.

Gjatë këtij sesioni, Kuvendi ka zgjedhur gjithsej 13 anëtarë të bordeve të institucioneve të pavarura. Ndërsa kanë dështuar të zgjedhin anëtarët e tri bordeve të tjera.¹⁶ Përveç anëtarëve të bordeve, Kuvendi gjithashtu këtë sesion ka zgjedhur edhe drejtorët e dy institucioneve të pavarura, të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit.

Politizimi i procesit të emërimit të anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura është një nga sfidat më të mëdha. Me qëllim të depolitizimit dhe departizimit të këtij procesi, me 15 gusht të këtij viti është nënshkruar edhe një memorandum i bashkëpunimit mes Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës me Ambasadën e Britanisë së Madhe.¹⁷ Kjo marrëveshje bashkëpunimi parasheh krijimin e një trupe të jashtme (kompani konsulente) që do të ndihmonte në aspektin teknik procesin e përzgjedhjes për 20 pozita të lira në poste të larta institucionale, përfshirë anëtarë të bordeve të institucioneve të pavarura. Lista e pozitave për të cilat do të asistoj kjo kompani konsulente nuk është publikuar, andaj është e vështirë të vlerësohet se cilat do të jenë implikimet ligjore në këtë rast.

¹⁵ Kjo informatë është marrë në ueb – faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës: <http://ëëë.assembly-kosova.org/?cid=1,1044>.

¹⁶ Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit.

¹⁷ Memorandumi i Bashkëpunimit i qasshëm në: http://assembly-kosova.org/common/docs/MEMORANDUM_BASHKEPUNIMI_MES_KUVENDIT_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_QEVERISE_SE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_DHE_QEVERISE_SE_MBRETERISE_SE_BASHKUAR.pdf





6. LOJALITETI I DEPUTETËVE NDAJ GRUPEVE PARLAMENTARE

Nga matja e lojalitetit të deputetëve¹⁸ të ndara sipas grupeve parlamentare, del që grupi parlamentar Lista Serbe ka përqindjen më të lartë të lojalitetit prej 98%, e pasuar nga grupi parlamentar 6+ me 96%. Me një përqindje pothuajse të barabartë të lojalitetit qëndrojnë dy partitë më të mëdha në pushtet PDK dhe LDK (94.90%, 94.61%). Shkalla e lojalitetit të deputetëve të partive në pushtet është më e lartë në krahasim me ato në opozitë. Grupi parlamentar i LVV-së mbetet grupi me deputetët më “rebel” nga të gjitha grupet tjera parlamentare me 89.62% të lojalitetit.


Nga krahasimi i lojalitetit që nga fillimi i kësaj legjislature shohim se grupi parlamentar që ka shënuar më së shumti rritje të lojalitetit për 2% është Lista Serbe, kurse grupi parlamentar i PDK-së dhe LDK-së kanë pësuar ulje të nivelit të lojalitetit për 2%. Ndërsa grupet e tjera parlamentare nuk kanë pësuar ndryshime.

Nga 120 deputetët e legjislaturës së V-të të Kuvendit, 39 prej tyre janë gra ndërsa 81 janë burra. Nga matja e lojalitetit në bazë të gjinisë del që burrat dhe gratë deputete në Kuvendin e Kosovës kanë të njëjtin nivel të lojalitetit me 93%. Përkundër përqindjes së lartë të lojalitetit të të dy gjinive, niveli i barabartë i lojalitetit është një tregues që thyen paragjykimet për një lojalitet më të madh të grave sesa të burrave. Për më tepër, nëse shikohet lojaliteti brenda grupeve parlamentare, atëherë shohim se deputetet gra të LVV-së dhe LDK-së janë më “rebele” në krahasim me deputetët burra të këtyre dy grupeve parlamentare.


18 Në kuadër të platformës Votalme.org është bërë matja e lojalitetit të deputetëve duke i krahasuar votimet e deputetëve me qëndrimet e grupeve të tyre parlamentare. Vlen të theksohet që kjo matje është bërë vetëm në rastet kur ka pasur deklaram të grupit parlamentar dhe përfshinë të gjitha votimet që nga fillimi i mandatit të Legjislaturës së V-të.



► FIGURA 10. Lojaliteti i deputetëve ndaj grupit të tyre parlamentar



► FIGURA 11. Lojaliteti i deputetëve nga perspektiva gjinore



7. UDHËTIMET E DEPUTETËVE JASHTË VENDIT

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë qenë mjaft aktiv sa i përket udhëtimeve jashtë vendit, duke realizuar 128 të tilla¹⁹. Këto udhëtime i kanë kushtuar buxhetit të Kuvendit mjaft shumë, duke arritur shumën prej rreth 110 mijë euro, që i bie se mesatarisht çdo udhëtim i deputetëve ka kushtuar përafërsisht 1 mijë euro. Shteti ku janë realizuar më së shumti udhëtime është Belgjika, me gjithsej 20 sosh.


Grupi parlamentar me më së shumti udhëtime jashtë vendit është grupi parlamentar i PDK-së. Deputetët e këtij grupi kanë realizuar gjithsej 55 udhëtime jashtë vendit.²⁰ Nga numri i përgjithshëm i deputetëve të këtij grupi (34) kanë udhëtuar 23 prej tyre, shpenzimet e të cilëve arrijnë shumën e mbi 50 mijë euro. Destinacioni më i frekuentuar i deputetëve të grupit parlamentar të PDK-së është Belgjika, ku janë realizuar 8 udhëtime. Nga të dhënat e disponueshme, del se deputeti me më së shumti udhëtime, nga grupi parlamentar i PDK-së është Xhavit Haliti, i cili ka udhëtuar 6 herë gjatë sesionit pranveror.²¹

Grupi i dytë parlamentar që ka realizuar më së shumti udhëtime është ai i LDK-së. Nga gjithsej 33 deputetë sa ka ky grup parlamentar, 19 prej tyre kanë realizuar 31 udhëtime të cilat kanë kushtuar rreth 25 mijë euro. Shteti në të cilin janë realizuar më së shumti udhëtime është Maqedonia, ndërsa deputeti me më së shumti vizita është Muhamet Mustafa me 5 vizita të realizuara.

Grupi parlamentar Lista Serbe është grupi i tretë me më së shumti udhëtime jashtë vendit. Nga 11 deputetë sa ka ky grup parlamentar, 5 prej tyre kanë realizuar gjithsej 7 udhëtime,²² të cilat kanë kushtuar rreth 9 mijë euro. Deputeti me më së shumti udhëtime është Slobodan Petrovič, i cili ka realizuar 3 udhëtime jashtë vendit. Nga të dhënat del se Kroacia është shteti ku janë realizuar më së shumti udhëtime (2) nga deputetët e Listës Serbe.

Grupi i katërt me më së shumti udhëtime është grupi parlamentar 6+. Deputetët e këtij grupi kanë udhëtuar 10 herë në 7

FIGURA 12. SHTETET KU JANË REALIZUAR UDHËTIMET E DEPUTETËVE



shtete të ndryshme. Këto udhëtime i kanë kushtuar buxhetit të Kuvendit të Kosovës mbi 8 mijë euro. Deputetët e grupit 6+ kanë udhëtuar më së shumti në Belgjikë, ku janë realizuar 3 udhëtime. Deputetët me më së shumti udhëtime janë M. fera Şinik (3) dhe Çerim Bajrami (3).

Në vendin e pestë qëndron grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, 5 nga 16 deputetët e së cilës kanë realizuar 6 udhëtime.²³ Këto 6 udhëtime kanë kushtuar rreth 7 mijë euro, kurse destinacioni më i vizituar është Franca (2). Deputetja Aida Dërguti dhe tanimë ish anëtar i LVV-së Ilir Deda janë deputetët me më së shumti udhëtime (nga dy secili).

Nga grupi parlamentar i AAK-së kanë udhëtuar vetëm 2 deputetë me nga një udhëtim jashtë vendit. Këto dy udhëtime kishin për destinacion Belgjikën dhe gjithsej kanë kushtuar mbi 2 mijë euro. Deputetët të cilët kanë udhëtuar jashtë vendit janë Pal Lekaj dhe Time Kadriaj.

Deputetja Valdete Bajrami është e vetmja deputete nga grupi parlamentar i NISMA-s që ka udhëtuar jashtë vendit. Ajo ka udhëtuar në Belgjikë ndërsa ky udhëtimi i saj i ka kushtuar Kuvendit të Kosovës rreth një mijë e treqind euro.

19 Prej 128 udhëtimeve të realizuara, të dhëna të plota ka vetëm për 112 prej tyre.

20 Nga numri i përgjithshëm i udhëtimeve prej 70, të dhëna të plota ka vetëm për 55 prej tyre.

21 Nga 12 udhëtime sa ka realizuar deputeti Xhavit Haliti, vetëm në 6 prej tyre janë paraqitur të dhëna të plota.

22 Nga 11 udhëtime të realizuara, të dhëna të plota ka vetëm për 7 prej tyre.

23 Nga 5 udhëtime, të dhëna ka vetëm për 4 prej tyre.

8. SHPENZIMET E KUVENDIT

Buxheti i Kuvendit për vitin 2016 është në shumën prej 9,389,515.00 euro. Ndarja e buxhetit sipas kategorive ekonomike është si në vijim: Paga dhe Mëditje 6,288,756.00 (66.98%), për Mallra dhe Shërbime 1,703,759.00 (18.15%), për Shpenzimet Komunale 241,000.00 (2.57%), Shpenzime Kapitale 1,096,000.00 (11.67%), si dhe Subvencione dhe Transfere 60,000.00 (0.64%).

Ndonëse me shumë vonesë, në fillim të muajit shtator Kuvendi ka publikuar shpenzimet e tre mujorit të parë të vitit. Ndërsa, shpenzimet e tre mujorit të dytë nuk janë publikuar ende por që janë diskutuar në KBF. Për periudhën

gjashtëmuajore të vitit 2016 Kuvendi ka shpenzuar 41.74% të buxhetit të planifikuar ose 3,919,304.64 euro ndërsa të pashpenzuara kanë mbetur edhe 51.26% e buxhetit ose në shifër 5,470,210.36 euro. Sipas kategorive ekonomike, për Paga dhe Mëditje janë shpenzuar 44.07%, për Mallra dhe Shërbime 41.81%, për Shpenzime Komunale 39.53%, për Shpenzime Kapitale 25.95%, dhe për Subvencione dhe Transfere 98.86%. Siç mund të shihet nga të dhënat e shpenzimeve del që pjesa më e madhe e buxhetit është shpenzuar për Paga dhe Mëditje. Ndërsa kategoria ekonomike për Subvencione dhe Transfere për gjashtë mujin e parë është shpenzuar pothuajse krejtësisht.

► TABELA 4. PLANIFIKIMI I BUXHETIT DHE SHPENZIMET E KUVENDIT PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2016

Kategoria ekonomike	Buxheti pas rishikimit	Shpenzimet	Mbetjet	Përqindja e realizimit
Paga dhe mëditje	6,288,756.00	2,767,788.57	3,520,967.43	44.07%
Mallra dhe shërbimet	1,703,759.00	712,412.27	991,346.73	41.81%
Shpenzimet komunale	241,000.00	95,275.81	145,724.19	39.53%
Subvencionet dhe transferet	60,000.00	59,320.00	680.00	98.86%
Shpenzimet kapitale	1,096,000.00	284,507.99	811,492.01	25.95%
Gjithsej	9,389,515.00	3,919,304.64	5,470,210.36	41.74%



REKOMANDIMET

1. BUXHETI T’I NËNSHTROHET DEBATIT PARLAMENTAR DHE KONSULTIMEVE ME PUBLIKUN

Një nga ligjet më të rëndësishme që miraton Kuvendi çdo vit është ai për buxhetin e shtetit. Me këtë ligj përcaktohet se si do të shpenzohen të hyrat shtetërore. Tani më pothuajse është bërë praktikë që miratimi dhe rishikimi i buxhetit nga Kuvendi të bëhet me procedura të përshpejtuara, pa debat të mirëfilltë parlamentar, pa konsultime të nevojshme me publikun. Procedurat e përshpejtuara për miratimin dhe rishikimin e buxhetit ndikojnë në planifikim jo të duhur, mos përfshirje të nevojave reale të qytetarëve, favorizim të grupeve dhe të rajoneve të caktuara. Kuvendi duhet të ndaloj praktikën e miratimit dhe rishikimit të buxhetit me procedura të përshpejtuara. Projektligji i buxhetit duhet t’i nënshtrohet afateve të rregullta kohore, konsultimeve të gjëra me publikun dhe debatit të mirëfilltë parlamentar me deputetët.

2. TË BËHET KONSOLIDIMI I LIGJEVE

Që nga konstituimi i institucioneve të shtetit e deri më tani, Kuvendi ka miratuar 652 ligje prej të cilave aktualisht në fuqi janë 408 prej tyre. Ligjet e miratuara nga Kuvendi hyjnë në fuqi në momentin e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Plotësim/ndryshimi i ligjeve është i shpeshtë, ndërsa gati gjysma e ligjeve të parapara në agjendën legjislative janë nga kjo kategori. Publikim i ligjeve të plotësuar/ndryshuara bëhet ndaras nga versioni bazik i ligjit, gjë që shpeshherë shkakton konfuzion gjatë referimit të ligjeve. Për më tepër, në projektligjet e plotësuar/ndryshuara janë përvjedhur edhe gabime të cilat i referohen neneve në ligjin bazik, nene të cilat realisht nuk ekzistojnë. Ligjet e publikuar në ueb faqen e Kuvendit të lidhen me ligjet e publikuara në Gazetën Zyrtare, si burimin zyrtar të publikimit të ligjeve. Kjo do të shkarkonte administratën e Kuvendit dhe referimi i ligjeve do të bëhej nga burimi zyrtar. Ligjet, përfshirë plotësim/ndryshimet duhet të konsolidohen në një version të vetëm të ligjit, duke e pastruar nga ato nene të cilat janë shfuqizuar.

3. TË BËHET RREGULLIMI I PROCEDURAVE TË PËRSHPEJTUARA PËR MIRATIM TË LIGJEVE NË KUVEND

Rregullorja e Kuvendit ka paraparë mundësinë e shmangies së procedurave nëse për këtë votojnë 2/3 e deputetëve të pranishëm. Kjo dispozitë është aktivizuar shpeshherë kur Qeveria ka kërkuar nga Kuvendi miratimin e projektligjeve me procedura të përshpejtuara, duke shmangur kështu afatet dhe procedurat e parapara për miratimin e ligjeve. Rregullorja e re e Kuvendit duhet të përcaktoj se shmangia nga rregullorja i referohet vetëm shkurtimeve të afateve kohore por jo edhe procedurave që duhet ndjekur për miratimin e ligjeve.

4. ZËVENDËSIMI I MINISTRAVE TË VOTOHET NGA KUVENDI

Zgjedhja e Kryeministrit dhe e Qeverisë bëhet nga Kuvendi me votat e shumicës së të gjithë deputetëve. Pas zgjedhjes, anëtarët e Qeverisë betohen në Kuvend. Në rastet e zëvendësimit të ministrave, të njëjtët nuk i nënshtrohen procesit të zgjedhjes nga Kuvendi e as aktit të betimit. Si rrjedhojë, të njëjtët, duke mos qenë të zgjedhur por të emëruar nga Kryeministri ndihen më pak të obliguar të raportojnë në Kuvend. Andaj, Rregullorja e re e Kuvendit duhet të parasheh zbatimin e procedurave të njëjta të zëvendësimit të ministrave sikurse në rastin e zgjedhjes kur formohet Qeveria.

5. TË PARASHIHEN SANKSIONE PËR RASTET E MOS MIRATIMIT TË RAPORTEVE TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA NGA KUVENDI

Raportet vjetore të punës së institucioneve të pavarura që janë themeluar nga Kuvendi, shqyrtohen nga komisionet funksionale, të cilat më pastaj së bashku me rekomandimet përcell për votim në seancë plenare. Raportet të cilat nuk miratohen nga Kuvendi për shkak të performancës së dobët të këtyre organeve, nuk shoqërohen me penalizime për udhëheqësit e tyre. Andaj, Kuvendi duhet të parasheh masa sanksionuese për udhëheqësit e këtyre institucioneve për të cilët dëshmohej për keq-enaxhim, keqpërdorim të pozitës së tyre apo performancë të dobët.



6. KRIJIMI I MINISTRISË PA PORTOFOL PËR MARRËDHËNIE ME KUVENDIN

Në kohën kur po diskutohet për zvogëlimin e kabinetit qeveritar, përkatësisht shkurtimin e numrit të ministrive, krijimi i ministrive të reja do të duket krejtësisht jopopullor. Megjithatë, duke parë në vazhdimësi mungesën e koordinimit në mes të Kuvendit dhe të Qeverisë, KDI e sheh të nevojshme krijimin e një ministrie të re pa portofol për marrëdhënie me Kuvendin apo, ngarkimin e ndonjë ministri ekzistues me këtë detyrë. Kjo, do të ndihmonte në planifikimin dhe përmbushjen më të mirë të agjendës legjislative.

7. HARTIM I PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT

Ndonëse Rregullorja e Kuvendit parasheh hartimin e një plani të punës, në vitin 2016 Kuvendi nuk kishte fare një plan të tillë. Arsyt kryesore kanë qenë për të pamundësuar matjen e përmbushjes së këtij plani, veçanërisht të agjendës legjislative. Mos përmbushja e agjendës legjislative i është atribuar si dështim i Qeverisë, pasi nuk kanë sjellë në Kuvend ligjet të cilat i kanë paraparë për miratim. Sidoqoftë, Kuvendi duhet të hartoj Planin e vet të Punës ashtu siç parashihet me rregullore si dhe të rrisë bashkëpunimin me Qeverinë gjatë planifikimit të agjendës legjislative.

REKOMANDIMET PËR KOMISIONET PARLAMENTARE

Ndonëse në rekomandimet e mëposhtëm për komisionet parlamentare mund të ketë përjashtime të pikave të caktuara për komisione të caktuara, ne kemi grumbulluar të gjitha rekomandimet të cilat u adresohen shumicës dërmuese të komisioneve.

1. Komisionet parlamentare kanë pasur zbatim të dobët të planeve të tyre të punës. Kryesisht kjo ka ardhur si pasojë e planifikimeve ambicioze të komisioneve në raport me kapacitetet për zbatim të tyre. Planet e Punës së komisioneve duhet të përmbajnë një afat kohor për fillimin dhe mbarimin e një aktiviteti të caktuar.
2. Numri i ministrave të ftuar për raportim nga të gjitha komisionet për këtë sesion ka qenë shumë i vogël. Komisionet duhet të rrisin rolin e tyre mbikëqyrës, duke ftuar më shumë ministra të linjës në raportim.

3. Projektligjet të shqyrtohen nga anëtarët e komisioneve me kujdes të shtuar, duke ndalur praktikën e votimit të tyre pa diskutim. Njëkohësisht deputetët duhet të përgatiten për takimet e komisioneve duke i lexuar paraprakisht materialet për pikat të cilat janë renditur në rend të ditës;
4. Deputetët e Listës Serbe të cilët janë anëtar në komisionet e Kuvendit, duhet të përfshihen më aktivisht në diskutimet në komisione. Në shumicën e mbledhjeve janë tërësisht pasiv në diskutime;
5. Komisioni për Bujqësi shumicën e mbledhjeve i zhvillon në gjuhën serbe duke mos ofruar përkthim në gjuhën shqipe për pjesëmarrësit që përcjellin punën e komisionit. Andaj, të ofrohet përkthim në gjuhën shqipe në këtë komision, dhe gjuhët tjera zyrtare në varësi të kompozicionit të pjesëmarrësve.
6. Periudha e shqyrtimit të projektligjeve në grupe punuese të komisioneve në shumë raste është tej zgjatur, duke kaluar afatet kohore. Grupet punuese duhet të caktojnë afate realiste për të përfunduar shqyrtimin e projektligjeve.
7. Pothuajse gjysma e komisioneve parlamentare (7 nga 15) nuk kanë përmbushur kriterin e Rregullores së Kuvendit për të mbajtur të paktën 2 mbledhje në muaj. Komisionet duhet të respektojnë këtë dispozitë të rregullores dhe të shtojnë numrin e mbledhjeve të mbajtura.
8. Komisionet kanë arritur që brenda sesionit pranverorë të mbikëqyrin zbatimin e vetëm 5 ligjeve nga 23 si ishin paraprë. Komisionet duhet të rrisin numrin e ligjeve të mbikëqyrura në raport me ato që i kanë paraparë me plan të punës.
9. Anëtarët e komisioneve nuk kanë qenë shumë të rregullt sa i përket pjesëmarrjes në mbledhje. Deputetët të jenë më të disiplinuar në pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e komisioneve.
10. Komisionet e përhershme parlamentare kanë në dispozicion buxhet prej 10 mijë euro, ndërsa ato funksioniale nga 5 mijë euro. Qëllimi i këtij fondi është mbulimi i shpenzimeve për aktivitete të komisioneve dhe angazhim të ekspertëve në rast nevojë. Në gjashtëmujorin e parë të vitit, të gjitha komisionet kanë shfrytëzuar vetëm 4.56% të këtij buxheti. Kjo është një përqindje jashtëzakonisht e vogël e shpenzimit të buxhetit. Komisionet duhet të bëjnë planifikim më të mirë për shfrytëzimin e këtij fondi.

ANEKS 1. Pjesëmarrja e Deputetëve në Takimet e Komisioneve Parlamentare

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Naser Osmani	22	0	0
Safete Hadërgjonaj	19	1	3
Jelena Bontić*	13	2	7
Adem Grabovci	16	2	6
Besa Gaxheri	21	1	1
Fikrim Damka	18	2	4
Shqipe Pantina*	3	0	1
Labinotë Demi-Murtezi	22	2	0
Bardhyl Metaj	20	2	2
Enver Hoti	0	/	22
Bali Muharremaj	0	/	22
Ilir Deda*	0	/	6

* *Deputetja Jelena Bontic që nga muaji qershor ka qenë në pushim të lehonisë.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Jasmina Zivkovic	20	0	2
Agim Ceku	14	1	8
Mufera Sinik	15	2	7
Fisnik Ismaili	0	/	22
Rrustem Berisha	0	/	22
Milka Vuletic	17	2	5
Slavko Simic	13	2	9
Veton Berisha	17	2	5
Danush Ademi	19	1	3
Agim Kikaj	19	5	3
Cerim Bajrami	14	0	8
Sasa Milosavljevic	18	0	4

|||||

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e AKK-së

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Albulena Haxhiu	7	0	1
Selvije Halimi	24	0	2
Danush Ademi	26	1	0
Agim Aliu	26	0	0
Agim Ademaj	23	1	3
Armend Zemaj	25	5	1
Donika Kadaj-Bujupi	0	/	26
Doruntinë Maloku-Kastrati	15	3	11
Milena Milicevic	21	0	5
Nezir Çoçaj	25	1	1
Valdete Bajrami	0	/	26

Komisioni për Integritet Evropiane

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Teuta Sahatqija*	6	0	2
Valdete Bajrami	0	/	14
Slobodan Petrovic	9	2	5
Xhavit Haliti	9	0	5
Rrustem Mustafa*	0	0	3
Luljeta Veselaj - Gutaj*	13	0	0
Vjosa Osmani-Sadriu	10	1	4
Arben Gashi	11	5	3
Ilir Deda*	4	0	6
Time Kadrijaj	0	/	14
Kujtim Paçaku	9	0	5
Bislim Zogaj	11	0	0
Njomza Emimi	5	0	2
Donika Kadaj-Bujupi	3	0	1
Fatmir Xhelili	1	0	0

*Deputetja/kryetarja Teuta Sahatqija është zëvendësuar nga deputetja Njomza Emimi pas mbledhjes së tetë (8)

*Deputeti Rrustem Mustafa është zëvendësuar nga deputeti Bislim Zogaj pas mbledhjes së tretë(3)

*Deputeti Ilir Deda është zëvendësuar nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi pas mbledhjes së dhjetë (10)

*Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj është zëvendësuar nga deputeti Fatmir Xhelili pas mbledhjes së trembëdhjetë (13)

|||||

|||||

Komisioni për Punë të Jashtme

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Enver Hoxhaj*	5	0	1
Teuta Rugova	5	0	4
Cerim Bajrami	7	0	2
Blerta Deliu Kodra	6	0	3
Elmi Reçica	8	0	1
Ismet Beqiri	5	2	4
Glauk Konjufca*	2	0	4
Zafir Berisha	2	1	7
Puhie Demaku	2	0	1

*Deputeti Enver Hoxhaj ka dhënë dorëheqje nga mandati i deputetit pas emërimit si ministër i Punëve të Jashtme në mbledhjen e gjashtë (6).

*Deputeti Glauk Konjufca është zëvendësuar me deputeten Puhie Demaku pas mbledhjes së gjashtë (6).

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Nait Hasani	26	0	2
Salih Morina	25	8	3
Serdjan Popovic	20	3	8
Bekim Haxhiu	18	5	10
Shpejtim Bulliqi	27	2	1
Ismajl Kurteshi	6	0	2
Shukrije Bytyqi	0	/	28
Mufera Sinik	18	3	10
Teuta Haxhiu	0	/	28

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Muhamet Mustafa	27	0	1
Visar Ymeri*	0	/	21
Sasa Milosavljevic	22	1	6
Besim Beqaj	23	3	5
Blerim Grainca	26	0	2
Duda Balje	17	4	11
Enver Hoti	0	0	28
Fatmir Rexhepi	18	2	10
Pal Lekaj	0	0	28
Raif Qela	28	1	0
Sala Berisha Shala	25	3	3
Glauk Konjufca	0	0	7

Deputeti Visar Ymeri është zëvendësuar me deputetin Glauk Konjufca pas mbledhjes së tetëmbëdhjetë (18).

|||||

|||||

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Fikrim Damka*	3	0	1
Serdjan Popovic	16	3	1
Salih Salihu	3	0	1
Adem Salihaj	17	0	0
Emilija Redzeqi	16	1	1
Lahi Brahimaj	0	/	17
Murat Hoxha	17	1	0
Shaip Muja	14	2	3
Haxhi Shala	0	/	17
Duda Balje*	12	0	1

*Fikrim Damka është zëvendësuar me deputeten Duda Balje pas mbledhjes së tretë (3).

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Zenun Pajaziti	10	0	0
Sadri Ferati	10	2	0
Kujtim Paçaku	8	0	2
Alma Lama*	7	1	2
Jelena Bontic*	7	3	2
Pal Lekaj	0	/	10
Shqipe Pantina	2	0	8
Xhevahire Izmaku	10	1	0
Zafir Berisha	0	/	10

*Deputetja Jelena Bontic që nga muaji qershor ka qenë në pushim të lehonisë.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Daut Haradinaj	1	0	0
Fadil Demaku	9	0	2
Bojan Mitic	9	2	2
Anton Quni	8	1	3
Ganimete Musliu	8	3	3
Nuredin Ibishi	9	0	2
Zafir Berisha	1	0	0
Cerim Bajrami	8	2	3
Rexhep Selimi	2	1	2

|||||

|||||

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Faton Topalli	4	0	0
Ali Sadriu	12	0	0
Fikrim Damka*	5	2	5
Naim Fetahu	12	1	0
Synavere Ryshta	8	0	4
Hajdar Beqa	10	4	2
Abdyl Ymeri	8	0	4
Enver Hoti	0	/	12
Bali Muharremaj	0	/	12
Duda Balje*	1	0	1

*Deputetja Duda Balje është zëvendësuar me deputetin Fikrim Damka pas mbledhjes së tretë.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Flora Brovina	14	0	1
Njomza Emmini*	7	0	3
Fikrim Damka	13	1	2
Adem Hodza	11	1	4
Besa Baftiu	4	1	11
Fadil Beka	13	1	2
Hatim Baxhaku	15	2	0
Shukrije Bytyqi	0	/	15
Time Kadrijaj	0	/	15
Mirjeta Kalludra	4	1	0

*Deputetja Njomza Emmini është zëvendësuar nga deputetja Mirjeta Kalludra pas mbledhjes së dhjetë (10).

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Intelejencë

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Duda Balje	7	/	0
Rafet Rama	6	/	1
Nuredin Lushtaku	4	/	3
Milazim Haliti	7	/	0
Melihate Termkolli	6	/	1
Adem Hodza	1	/	6
Nenad Rasic	4	/	3
Aida Derguti	1	/	6
Haxhi Shala	0	/	7
Rrustem Berisha	0	/	7

|||||

|||||

Komisioni Parlamentar për Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Xhavit Haliti	5	/	0
Sabri Hamiti	5	/	0
Adem Grabovci	4	/	1
Donika Kadaj - Bujupi	2	/	3
Ismet Beqiri	5	/	0
Kujtim Paçaku	3	/	2
Valdete Bajrami	5	/	0
Muhamet Mustafa	4	/	1
Nenad Rasic	5	/	0
Selvije Halimi	5	/	0
Time Kadrijaj	5	/	0
Visar Ymeri	2	/	3

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Personat e Pagjetur dhe Peticione

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Lirije Kajtazi	10	2	1
Salihe Mustafa	11	3	0
Nenad Rasic	10	1	1
Mexhide Mjeku Topalli	11	1	0
Etem Arifi	8	1	3
Mytaher Haskuka	3	0	1
Teuta Haxhiu	0	/	11
Valdete Bajrami	0	/	11
Kujtim Paçaku	8	3	3

|||||

ANEKS 2. PJESËMARRJA E DEPUTETËVE NË SEANCA

Numri i seancave sipas muajve 3 4 2 2 3 4 2 1

Emri dhe Mbiemri	Grupi parlamentar	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Pjesëmarrje	Mungesa
Adem Hodža	LS		2	4	1	1	3	2	1	0	14	7
Abdyl Ymeri	PDK		-	4	2	2	3	4	2	1	18	0
Adem Salihaj	LDK		2	4	2	2	3	4	2	1	20	1
Adem Grabovci	PDK		2	4	2	2	3	4	2	1	20	1
Agim Ademaj	LDK		3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Agim Aliu	PDK		3	3	2	2	3	2	2	1	18	3
Agim Çeku	PDK		3	3	2	1	2	3	2	1	17	4
Aida Dërguti	LVV		0	1	0	0	3	2	1	1	8	13
Albin Kurti	LVV		0	0	0	0	1	1	2	1	5	16
Albulena Haxhiu	LVV		0	0	0	0	2	3	2	1	8	13
Ali Berisha	AAK		-	1	0	0	0	0	0	1	2	16
Ali Sadriu	LDK		3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Alma Lama	LDK		3	3	2	1	2	4	0	-	15	5
Anton Quni	LDK		2	4	2	2	3	4	2	1	20	1
Arben Gashi	LDK		2	4	2	2	3	3	2	1	19	2
Armend Zemaj	LDK		3	4	2	1	3	4	2	1	20	1
Fadil Demaku	PDK		3	4	2	1	0	4	2	1	17	4
Milazim Haliti	LDK		3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Azem Syla	PDK		3	4	0	-	-	-	-	-	7	2
Bali Muharremaj	AAK		0	1	0	0	0	0	0	1	2	19
Bekim Haxhiu	PDK		3	4	2	1	2	4	2	1	19	2
Besa Baftiu	LVV		0	1	0	0	3	4	2	1	11	10
Besa Gaxherri	LDK		3	4	2	1	3	4	2	1	20	1
Besim Beqaj	PDK		3	4	1	1	3	1	2	1	16	5
Besnik Bislimi	LVV		0	0	0	-	-	-	-	-	0	9

|||||

Bislim Zogaj	PDK	3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Blerim Grainca	LDK	3	4	2	1	3	1	2	1	17	4
Blerim Shala	Pa Grup	3	4	2	1	3	3	2	1	19	2
Blerta Deliu-Kodra	PDK	2	3	2	2	3	4	2	1	19	2
Bojan Mitić	LS	3	4	2	0	3	4	2	0	18	3
Danush Ademi	6+	3	4	2	1	2	4	2	1	19	2
Faton Topalli	LVV	0	0	0	0	3	2	0	1	6	15
Daut Haradinaj	AAK	0	1	0	0	0	0	0	1	2	19
Donika Kadaj - Bujupi	LVV	0	1	0	0	2	4	2	0	9	12
Doruntinë Maloku - Kastrati	LDK	3	4	2	0	3	4	2	1	19	2
Driton Çaushti	LVV	-	-	-	0	0	4	2	1	7	5
Duda Balje	6+	3	3	2	0	3	4	1	1	17	4
Salihe Mustafa	PDK	3	4	2	2	3	3	2	1	20	1
Elmi Reçica	PDK	3	3	2	2	3	4	2	1	20	1
Emilija Redžepi	PDK	3	4	2	2	3	4	1	1	20	1
Enver Hoxhaj	PDK	3	1	0	1	-	-	-	-	5	6
Etem Arifi	LDK	3	3	2	1	3	4	2	1	19	2
Fadil Beka	PDK	3	4	2	2	3	3	2	1	20	1
Fatmir Rexhepi	LDK	3	2	1	1	3	2	2	1	15	6
Fatmir Limaj	NISMA	3	1	0	0	0	0	0	1	5	16
Fatmir Xhelili	PDK	-	-	-	-	2	4	2	1	9	1
Fisnik Ismajli	LVV	0	1	0	0	1	2	2	1	7	14
Flora Brovina	PDK	3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Ganimete Musliu	PDK	2	4	2	2	2	4	2	1	19	2
Gëzim Kelmendi	Pa Grup	2	2	2	1	3	4	1	1	16	5
Glauk Konjufca	LVV	0	0	0	0	3	3	2	0	8	13
Shaip Muja	Pa Grup	2	4	2	1	3	3	2	1	18	3
Nait Hasani	PDK	3	4	2	0	3	4	2	1	19	2
Bardhyl Meta	LDK	3	4	0	1	3	4	2	1	18	3
Hatim Baxhaku	LDK	2	4	2	2	3	3	2	1	19	2
Haxhi Shala	NISMA	0	1	0	0	0	0	0	1	2	19
Synavere Rysha	LDK	3	4	2	2	3	0	1	1	16	5
Ilir Deda	Pa Grup	0	1	0	0	0	0	0	1	2	19
Murat Hoxha	LDK	3	3	1	1	3	4	1	1	17	4

|||||

|||||

Ismajl Kurteshi	LVV	0	1	0	0	2	4	2	1	10	11
Ismet Beqiri	LDK	3	3	2	2	3	3	2	1	19	2
Enver Hoti	NISMA	0	1	0	0	0	0	0	1	2	19
Jasmina Živković	LS	3	4	1	1	3	4	2	0	18	3
Jelena Bontić	LS	3	3	1	1	3	0	0	0	11	10
Kadri Veseli	PDK	3	2	2	2	3	4	2	1	19	2
Kujtim Paçaku	6+	3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Agim Kikaj	LDK	3	3	2	1	3	4	2	1	19	2
Labinotë Demi – Murtezi	PDK	3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Lahi Brahimaj	AAK	0	1	0	0	0	0	0	1	2	19
Lirije Kajtazi	LDK	3	4	2	1	3	4	2	1	20	1
Luljeta Veselaj – Gutaj	PDK	3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Fikrim Damka	6+	3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Margarita Kadriu	Pa Grup	2	4	2	1	1	2	0	1	13	8
Melihate Tërmkolli	LDK	3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Hajdar Beqa	PDK	3	4	2	2	3	3	2	1	20	1
Mirjeta Kalludra	LDK	-	-	-	2	3	3	2	1	11	1
Mexhide Mjaku - Topalli	PDK	3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Milena Miličević	LS	3	4	2	1	3	4	2	0	19	2
Milka Vuletić	LS	3	4	2	1	3	4	2	0	19	2
Mufera Srbica - Sinik	6+	2	4	2	2	3	4	2	1	20	1
Muhamet Mustafa	LDK	3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Mytaher Haskuka	LVV	0	0	0	0	3	4	1	1	9	12
Naim Fetahu	PDK	3	3	2	2	3	3	2	1	19	2
Naser Osmani	LDK	3	4	1	1	3	3	0	1	16	5
Nenad Rashiq	LS	3	4	2	1	3	3	2	0	18	3
Nezir Çoçaj	PDK	3	4	2	2	3	2	1	1	18	3
Njomza Emimi	LDK	3	4	1	0	0	4	2	1	15	6
Nuredin Ibishi	LDK	3	3	2	2	3	3	2	1	19	2
Nuredin Lushtaku	PDK	3	3	1	1	3	2	1	1	15	6
Pal Lekaj	AAK	0	1	0	0	0	0	0	1	2	19
Puhie Demaku	VV	0	1	0	0	2	3	2	1	9	12
Rafet Rama	PDK	3	4	2	0	3	1	2	1	16	5
Raif Qela	PDK	3	4	2	2	3	3	2	1	20	1

|||||

|||||

Ramiz Kelmendi	Pa Grup	2	3	1	0	2	2	1	1	12	9
Ramush Haradinaj	AAK	0	-	-	-	-	-	-	-	0	3
Cerim Bajrami	6+	3	3	2	1	3	4	2	1	19	2
Rexhep Selimi	LVV	0	1	0	0	0	4	2	1	8	13
Rrustem Berisha	AAK	0	1	0	0	0	0	0	1	2	19
Sabri Hamiti	LDK	3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Sadri Ferati	LDK	2	4	2	2	3	2	1	1	17	4
Safete Hadërgjonaj	PDK	3	4	2	2	2	4	0	1	18	3
Sala Berisha - Shala	PDK	3	3	2	2	3	3	2	1	19	2
Salih Salihu	LVV	1	2	0	0	3	3	2	1	12	9
Salih Morina	LDK	2	3	2	1	3	4	2	1	18	3
Saša Milosavlević	LS	3	4	1	0	3	3	1	0	15	6
Selvije Halimi	PDK	3	4	2	1	3	4	2	1	20	1
Shpejtim Bulliqi	LDK	2	4	2	1	3	4	2	1	19	2
Shqipe Pantina	LVV	0	0	0	0	3	3	0	1	7	14
Shukri Buja	PDK	-	-	-	-	0	4	2	1	7	3
Shukrije Bytyqi	NISMA	0	1	0	0	0	0	0	1	2	19
Slavko Simić	LS	3	4	2	0	3	4	2	0	18	3
Slobodan Petrović	LS	2	4	1	1	3	3	0	0	14	7
Teuta Haxhiu	AAK	1	1	0	0	0	0	0	1	3	18
Teuta Rugova	LDK	3	3	2	2	3	4	1	0	18	3
Teuta Sahatqija	LDK	3	4	-	-	-	-	-	-	7	0
Time Kadrijaj	AAK	0	0	0	0	0	0	0	1	1	20
Valdete Bajrami	NISMA	0	1	0	0	0	0	0	1	2	19
Srdjan Popović	LS	3	4	1	1	3	2	2	0	16	5
Veton Berisha	LDK	3	3	2	2	3	4	2	1	20	1
Visar Ymeri	LVV	0	0	0	0	2	4	2	1	9	12
Vjosa Osmani - Sadriu	LDK	0	3	2	2	2	3	2	1	15	6
Xhavit Haliti	PDK	3	2	2	2	3	2	2	1	17	4
Xhevahire Izmaku	PDK	3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Zafir Berisha	NISMA	1	1	0	0	0	0	0	1	3	18
Zenun Pajaziti	PDK	3	4	2	2	3	4	2	1	21	0
Kimete Bytyqi	LDK	-	-	-	-	-	-	-	1	1	0

|||||

ANEKS 3. PYETJET PARLAMENTARE SIPAS SEKTORËVE

Deputeti/ja	Grupi parlamentar	Financa	Tregti	Ekonomi	Punë të jashtme	Infrastrukturë	Komunikacion	Qeverisje Lokale	Energjetikë	Anti-Korrupsion	Ambient	Siguri	Drejtësi	Shëndetësi	Arsim	Administratë	Metallurgji	Sport	Kulturë	Bujqësi	Drejtë të Njeriut	Punë të brendshme	Sociale	Gjithsej	Përgjigjur
Abdyl Ymeri	PDK		1	1	1	1									1			1	1					5	3
Bekim Haxhiu	PDK				1	1									1				1					3	1
Bislim Zogaj	PDK														1									1	1
Blerta Deliu-Kodra	PDK													1									1	2	1
Ganimete Musliu	PDK														2							1		4	4
Labinotë Demi-Murtezi	PDK														1								1	2	2
Mexhide Mjaku-Topalli	PDK	2										1			1								3	7	7
Rafet Rama	PDK																					1		1	0
Raif Qela	PDK			1																		1		4	2
Sala Berisha-Shala	PDK					1																		1	1
Salihe Mustafa	PDK					1								1									1	3	3
Alma Lama	LDK											1												5	4
Njomza Emiri	LDK													1									1	2	1
Albulena Haxhiu	LWV	2																				1		3	2
Besa Baffiu	LWV													3	1									4	3
Donika Kadaj-Bujupi	LWV	1																				1		2	1
Faton Topalli	LWV																					4		4	0
Ismajl Kurteshi	LWV	2	1			1						3		5	4							3	3	22	5
Mytahir Haskuka	LWV																		1					1	0
Puhie Demaku	LWV			2																				2	1
Salih Salihu	LWV																			1				2	1
Shqipe Pantina	LWV												1											1	0
Danush Ademi	PDAK																							1	1
Slavko Simic	SL																							1	1
Gjithsej pyetje:		7	1	2	2	7	0	0	0	0	0	2	5	6	14	4	1	2	2	1	2	14	11	83	45

“Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”. Përmajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA